REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr._____, datë_____

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT "PËR TURIZMIN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Propozimin e projektligjit *"Për turizmin"*

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

P R O J E K T L I G J

Nr._____, datë _____

"PËR TURIZMIN[1]"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të promovojë Shqipërinë si destinacion turistik tërheqës për vizitorë vendas e të huaj, duke mbështetur zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve turistike të përmbushin kërkesat e turistëve, në një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt, dhe duke respektuar nevojat e komuniteteve pritëse të sotme dhe të brezave të ardhshëm.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji janë:

1. Rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, personave fizikë e juridikë, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari turistike dhe përcaktimi i të drejtave e detyrimeve të subjekteve pjesëmarrëse në këto veprimtari, në përputhje me standardet e

---

1 Ky ligj është përafruar pjesërisht me Direktivën 2006/123/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, "Për shërbimet në tregun e brendshëm" (CELEX No. 32006L0123), si dhe me Direktivën (BE) 2015/2302 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 25 nëntor 2015, për paketat e udhëtimit dhe organizimet e lidhura të udhëtimit, që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 2006/2004 dhe Direktivën 2011/83/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe shfuqizon Direktivën 90/314/KEE të Këshillit (CELEX No. 32015L2302), të ndryshuar me Direktivën (BE) 2026/1024 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 29 prill 2026 (CELEX No. 32026L1024).

përcaktuara në këtë ligj, si dhe çështje të tjera që lidhen me fushën e turizmit.

2. Rregullimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit e të ndërveprimit të organeve të qeverisjes qendrore me ato të qeverisjes vendore në përcaktimin e politikave dhe zhvillimit të strategjive në fushën e turizmit.

3. Përcaktimi i rregullave për bashkërendimin e punës dhe bashkëveprimin e institucioneve përgjegjëse në fushën e turizmit, me qëllim zhvillimin e industrisë së turizmit sipas rregullave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.

4. Rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet institucioneve shtetërore dhe investitorëve potencialë, bazuar në interesin publik për zhvillimin e turizmit.

Neni 3

Subjektet dhe fusha e zbatimit

1. Personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, që zhvillojnë veprimtari turistike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, veprojnë në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

2. Personat fizikë dhe juridikë që zhvillojnë veprimtari turistike në baza kontraktuale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë veprojnë në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, për aq sa këto dispozita nuk bien në kundërshtim me legjislacionin e shtetit ku ushtrohet veprimtaria dhe, kur është e zbatueshme, me të drejtën e Bashkimit Europian.

3. Nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, ofruesit e shërbimeve të vendosur në shtetet anëtare të Bashkimit Europian ose të Zonës Ekonomike Europiane gëzojnë të njëjtat të drejta dhe i nënshtrohen të njëjtave kushte si ofruesit vendas, pa diskriminim për shkak të shtetësisë, vendit të themelimit ose vendbanimit, përveç kufizimeve të justifikuara, të domosdoshme dhe proporcionale sipas së drejtës së Bashkimit Europian.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Agroturizëm" është veprimtaria pritëse që zhvillohet në një fermë ose njësi tjetër agrikulturore, me qëllimin për të tërhequr vizitorë, shpeshherë duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtaritë bujqësore ose veprimtaritë e tjera ndihmëse që zhvillohen në atë mjedis bujqësor. Agroturizmi mbështet zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm të zonave rurale nëpërmjet mbrojtjes së ambientit, ruajtjes së traditave dhe promovimit të produkteve tipike të zonës.

2. "Agjenci udhëtimi" është çdo person fizik ose juridik që ushtron veprimtari tregtare, i cili, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose si ndërmjetës, mbi bazën e një marrëdhënieje kontraktore merr përsipër t'u ofrojë udhëtarëve, si individë apo të organizuar në grup, shërbimet e përcaktuara në nenin 47 të këtij ligji. Kur agjencia e udhëtimit shet ose ofron për shitje një paketë udhëtimi të kombinuar nga një organizator, në kuptim të dispozitave për paketat e udhëtimit, ajo konsiderohet "shitës me pakicë".

3. "Apartament" është një njësi banimi, e destinuar për të ofruar shërbime akomodimi për turistët, e përbërë minimalisht nga një dhomë ndenjeje ose kuzhinë, një ose më shumë dhoma gjumi dhe me të paktën një tualet.

4. "Bujtinë" (shtëpi pritëse) është një ndërtesë, një pjesë e së cilës përdoret si rezidencë e pronarit dhe ku ofrohet akomodim dhe ushqim për turistët, përkundrejt pagesës.

5. "Burim turistik" është tërësia e elementeve dhe/ose faktorëve, si potenciale që mundësojnë prodhimin e një eksperience turistike, duke përfshirë burimet e prekshme, burimet e paprekshme si edhe burimet njerëzore.

6. "Certifikatë", në kuptim të këtij ligji, është dokumenti i lëshuar nga ministria përgjegjëse për turizmin ose institucioni i varësisë i përcaktuar sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore, që provon plotësimin e kërkesave dhe standardeve për ushtrimin, klasifikimin ose kategorizimin e veprimtarisë turistike.

7. "Certifikatë paraprake kategorizimi" është dokumenti i lëshuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, përpara miratimit të lejes së ndërtimit, që vërteton përputhshmërinë e projektit të propozuar me kushtet dhe kriteret për projektimin dhe ndërtimin e kategorisë përkatëse të strukturës akomoduese, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

8. "Destinacion turistik" është pikë turistike me një përqendrim të lartë të produkteve turistike, i ngritur mbi bazën e studimeve dhe planeve të zonës dhe që ka kapacitete për të tërhequr vizitorë, vendas e të huaj, duke plotësuar e kënaqur kërkesat e tyre.

9. "Dhomë" nënkupton një njësi të veçantë të një ndërtese rezidenciale ose e një njësie banimi, në të cilën ofrohet shërbimi i akomodimit për turistët.

10. "Ekskursion" është kombinim i organizuar, paraprakisht, i shërbimeve të transportit dhe shërbimeve të tjera, që shiten ose ofrohen për shitje brenda të njëjtit çmim, shërbime që ofrohen për një periudhë më të shkurtër se 24 orë dhe që nuk përfshijnë akomodimin gjatë natës.

11. "Ekskursionist" është vizitori që udhëton për qëllime turizmi pa kaluar natën në vendin e vizituar.

12. "Fjetinë" (Hostel) është ndërtesë që ofron akomodim dhe ushqim me çmime ekonomike, zakonisht për udhëtarë, studentë dhe punëtorë, ku dhoma ndahet mes disa klientëve të ndryshëm.

13. "Fjetje dhe mëngjes (B&B)" është strukturë akomoduese që ofron shërbimin e fjetjes dhe mëngjesit brenda çmimit të dhomës. Kjo strukturë akomoduese nuk ofron shërbim restoranti dhe ambiente të përbashkëta.

14. "Fshat turistik tradicional" është vend i banuar me një përqendrim të lartë të burimeve dhe sipërmarrjeve turistike, i cili ka kapacitet për të tërhequr vizitorë vendas e të huaj, me një infrastrukturë të harmonizuar dhe mjedise që plotësojnë kërkesat e tyre.

15. "Hotel" është strukturë akomoduese e organizuar si një njësi funksionale e vetme dhe e integruar, e vendosur në një ndërtesë të veçantë ose në një pjesë fizikisht dhe funksionalisht të pavarur të saj, me jo më pak se 6 dhoma, ku akomodimi dhe shërbime të tjera, si ushqimi, pijet dhe shërbimet mbështetëse, ofrohen nga një staf i kualifikuar, kundrejt një çmimi të afishuar.

16. "Hotel i shpërndarë" është një strukturë akomoduese, e cila ofron shërbime të mikpritjes për vizitorët, e përbërë nga shtëpi, apartamente ose dhoma të vendosura në ndërtesa të veçanta, ekzistuese, jo më pak se 200 m larg ndërtesës kryesore, të ndodhura në zona historike, muzeale

ose zona të tjera me vlera të trashëgimisë kulturore, të njohura nga ministria përgjegjëse për kulturën, dhe të menaxhuara në mënyrë të unifikuar nga i njëjti sipërmarrës turistik.

17. "Industri turistike" është tërësia e bizneseve që ofrojnë shërbime dhe lehtësi të tjera në funksion të fushës së turizmit.

18. "Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special" nënkupton subjektin, i cili financon dhe/ose merr përsipër ndërtimin e strukturave akomoduese me 4 ose 5 yje, status special, dhe që përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 39 të këtij ligji.

19. "Kalendari turistik i aktiviteteve zbavitëse" është programi gjithëvjetor, që përfshin të gjitha ngjarjet kulturore, të traditës, sportive dhe natyrore, të cilat ofrojnë zbavitje dhe kënaqësi për turistët në të gjithë territorin e Shqipërisë. Ky kalendar publikohet çdo vit në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe të institucionit përgjegjës për promovimin e turizmit, si dhe në platformat online të menaxhuara prej tij.

20. "Kamper" është mjet motorik i pajisur me kushte të përshtatshme qëndrimi, për ushtrimin e një aktiviteti turistik që ruan aftësinë e përhershme të mjetit lëvizës për t'u zhvendosur në çdo kohë.

21. "Kamping" është zonë publike ose private e rrethuar, e pajisur me infrastrukturë të domosdoshme (ujë, tualete, energji elektrike etj.), ku udhëtarët mund të akomodohen në tendat e kampingut, apo të ngrenë tendat e tyre, ose të parkojnë mjetin motorik akomodues (kamper).

22. "Kontratë e paketës së udhëtimit" është kontrata që mbulon paketën e udhëtimit në tërësi ose, kur paketa ofrohet nëpërmjet kontratave të veçanta, tërësia e kontratave që mbulojnë shërbimet e udhëtimit të përfshira në paketë.

23. "Licencë" është akti administrativ i përcaktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

24. "Ministria përgjegjëse për turizmin" është ministria që ka si fushë përgjegjësie turizmin.

25. "Motel" është ndërtesë që ofron shërbim akomodimi dhe parkimi, zakonisht me synimin për qëndrim të shkurtër të udhëtarëve, me vend-ndodhje në periferi të qendrave të banuara, pranë kryqëzimeve dhe rrugëve automobilistike.

26. "Ngjarje me interes për turizmin" janë festivalet, koncertet, spektaklet, shfaqjet, veprimtaritë kulturore, artistike, sportive, gastronomike, të traditës dhe ngjarje të tjera, të cilat, për shkak të natyrës, përmbajtjes ose përmasave të tyre, kontribuojnë në promovimin e Shqipërisë si destinacion turistik, tërheqjen e vizitorëve dhe zhvillimin e ofertës turistike.

27. "Njësi akomoduese për qëndrime afatshkurtra" është apartamenti, vila, banesa ose dhoma, e mobiluar dhe e përshtatur për akomodimin e përkohshëm të turistëve apo vizitorëve, që ofrohet kundrejt pagesës, drejtpërdrejt ose nëpërmjet platformave elektronike.

28. "Ofruesi i shërbimeve turistike" është sipërmarrja turistike e transportit, akomodimit, argëtimit dhe e të gjitha shërbimeve të tjera për kalimin e kohës së lirë.

29. "Operatori turistik" është personi fizik ose juridik që zhvillon veprimtari tregtare që lidhet me organizimin dhe ofrimin e shërbimeve turistike dhe të udhëtimit, përfshirë kombinimin dhe shitjen ose ofrimin për shitje të paketave të udhëtimit, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një agjencie udhëtimi, dhe që lidh kontrata me ofruesit e shërbimeve turistike ose të udhëtimit për realizimin e këtyre shërbimeve. Për qëllimet e dispozitave për paketat e udhëtimit, operatori turistik, kur kombinon dhe shet ose ofron për shitje një paketë udhëtimi, drejtpërdrejt, nëpërmjet një tregtari tjetër ose së bashku me një tregtar tjetër, konsiderohet "organizator", sipas përkufizimit të këtij ligji.

30. "Operator menaxhues në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special" nënkupton grupin hotelier, i cili merr përsipër operimin dhe menaxhimin e një strukture akomoduese me 4 ose 5 yje, status special, drejtpërdrejt apo nëpërmjet kontratave "franchising" apo kontratave të tjera, të ngjashme me këtë të fundit.

31. "Organizator", në kuptim të dispozitave për paketat e udhëtimit, është tregtari, i cili kombinon paketat e udhëtimit dhe i shet ose i ofron për shitje, drejtpërdrejt, nëpërmjet një tregtari tjetër, si dhe tregtari që transmeton të dhënat e udhëtarit tek një tregtar tjetër në rastet e përcaktuara në nënndarjen "v" të shkronjës "b" të pikës 1 të nenit 60 të këtij ligji.

32. "Paketë udhëtimi" është kombinimi i të paktën dy llojeve të ndryshme të shërbimeve të udhëtimit për qëllime të të njëjtit udhëtim ose pushim, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të nenit 60 të këtij ligji.

33. "Palët e CEFTA-s" janë palët kontraktuese të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore (CEFTA), si dhe çdo palë tjetër që i bashkohet Marrëveshjes në përputhje me kushtet dhe procedurat e saj.

34. "Pikë shitjeje" është çdo ambient tregtar i paluajtshëm ose i lëvizshëm, ose një faqe interneti për shitje me pakicë apo mjet i ngjashëm shitjeje online, përfshirë rastet kur faqet e internetit për shitje me pakicë ose mjetet e shitjes online u paraqiten udhëtarëve si një mjet i vetëm, përfshirë edhe shërbimin telefonik.

35. "Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit" është plani i hartuar në përputhje me ligjin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe strategjinë kombëtare të zhvillimit të turizmit, i cili miratohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

36. "Plazh" është hapësira me rërë, zhavorr apo shkëmb, që shtrihet në buzë të ujit të detit, lumit ose liqenit, e identifikuar si e përshtatshme për zonë çlodhjeje, argëtuese dhe që konsiderohet e parrezikshme nga pikëpamja shëndetësore apo e sigurisë për përdorim nga pushuesit.

37. "Plazh i lejuar" është plazhi i përcaktuar si i tillë nga organet përgjegjëse, në të cilin lejohet të ushtrohet veprimtaria e stacionit të plazhit, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

38. "Produkt turistik" është tërësia e elementeve të ndërthurura, që organizohet si vlerë e veçantë zinxhir, e cila përmban produkte materiale dhe shërbime, vlera natyrore dhe kulturore, superstrukturë dhe infrastrukturë turistike.

39. "Punë artizanale" janë punë të bëra me dorë, me interes kulturor e historik, të prodhuara për shitje për turistët që përfshijnë punime druri, punime argjendi, qëndistari, punime në llak/vernik, prodhime xhami, kostume, gdhendje, punime guri, piktura, qeramikë, shportari dhe ndonjë lloj tjetër punimi të emërtuar si i tillë.

40. "Qendër kurative" është strukturë akomoduese me vendndodhje në zona me potenciale kuruese natyrore, të cilat stimulohen nga toka, uji, deti, rëra e klima dhe që shërbejnë për kryerjen e terapive kuruese.

41. "Regjistri kombëtar i burimeve turistike" është sistem informacioni që përmban një bazë të dhënash mbi burimet turistike të vendit.

42. "Regjistri Qendror i Turizmit" është regjistri publik i sipërmarrjeve turistike që mbahet sipas parashikimeve të këtij ligji dhe që ka qëllime statistikore.

43. "Resort" është kompleks ndërtesash për pushim dhe argëtim, të grupuara e të administruara së bashku, si hotele, apartamente, vila, studio, që u ofron klientëve akomodim,

ushqim, pije, veprimtari sportive e argëtuese dhe shërbime ndihmëse, nëpërmjet një stafi të kualifikuar.

44. "Resort miks" është zhvillimi i integruar me funksion kryesor turistik, i cili:

a) përfshin një strukturë akomoduese të kategorisë "Resort", njësi me funksion rezidencial, si dhe ambiente, shërbime dhe infrastrukturë të përbashkët në funksion të zhvillimit;

b) pajiset me certifikatë paraprake kategorizimi për të gjithë projektin, sipas këtij ligji;

c) mund të përfshijë njësi me funksion rezidencial që mund të jenë objekt i pronësisë dhe disponimit të veçantë;

ç) pas përfundimit të ndërtimit, i nënshtrohet kategorizimit dhe klasifikimit vetëm për pjesën e destinuar për ushtrimin e veprimtarisë akomoduese, sipas këtij ligji.

45. "Sipërmarrës turistik" është personi fizik ose juridik, i krijuar sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i cili kryen veprimtari në fushën e turizmit.

46. "Sipërmarrje turistike" është veprimtari turistike e ndërmarrë nga personi fizik ose juridik, e krijuar sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

47. "Stacion plazhi" është veprimtari turistike e ushtruar në struktura të ndodhura pranë bregut të detit, të liqeneve ose lumenjve, të pajisura me kabina për plazh, dhoma zhveshjeje, shërbime higjienike, dushe që, sipas rastit, ofron shërbimin e ushqimit dhe pijeve.

48. "Strukturë akomoduese" është struktura që vë në dispozicion të turistëve, vendas apo të huaj, individë ose të organizuar në grupe, për një periudhë kohe të pacaktuar, por jo më shumë se 1 vit, shërbimet e akomodimit si fjetje, ushqim, pije dhe shërbime të tjera, në përputhje me standardet e përcaktuara sipas këtij ligji.

49. "Strukturë akomoduese e trashëgimisë kulturore" është struktura e përcaktuar si pasuri kulturore në përputhje me legjislacionin për trashëgiminë kulturore dhe që kategorizohet, për sa është e mundur, sipas përcaktimeve të legjislacionit të turizmit.

50. "Strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special" nënkupton strukturën akomoduese, që përfshin hotelin dhe/ose resortin me 4 ose 5 yje, e cila përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 39 të këtij ligji.

51. "Strukturë e njësive akomoduese të menaxhuara" është struktura akomoduese e përbërë nga dy ose më shumë njësi akomoduese për qëndrime afatshkurtra, të cilat, pavarësisht pronësisë, administrohen dhe ofrohen në mënyrë të unifikuar nga i njëjti person fizik ose juridik, në bazë të një marrëdhënieje juridike të vlefshme. Administrimi i unifikuar përfshin menaxhimin e rezervimeve, regjistrimin dhe raportimin e klientëve, organizimin e pritjes, pastrimit dhe mirëmbajtjes, trajtimin e ankesave dhe përgjegjësinë për respektimin e standardeve të akomodimit, sigurisë dhe higjienës.

52. "Suvenire" janë mallra, harta, fotografi, kartolina dhe mallra të tjera të këtij lloji, të ndryshme nga ato të bëra me dorë, që u shiten turistëve si kujtim të vizitës së tyre në Shqipëri.

53. "Shërbim turistik" është lehtësia që u ofrohet turistëve nga sipërmarrja turistike.

54. "Shërbim turistik i vizitave panoramike me autobus (Open Bus / Hop-on Hop-off)" është shërbimi i transportit turistik që realizohet me autobusë të përshtatur për vizita panoramike, sipas itinerareve dhe ndalesave të përcaktuara, me qëllim njohjen e atraksioneve dhe destinacioneve turistike, duke u mundësuar turistëve të hipin dhe të zbresin në ndalesa të ndryshme përgjatë itinerarit, sipas kushteve të shërbimit.

55. "Shërbim udhëtimi" është:

a) transporti i pasagjerëve;

b) akomodimi që nuk përbën pjesë të pandashme të transportit të pasagjerëve dhe që nuk ofrohet për qëllime banimi;

c) marrja me qira e automjeteve ose mjeteve të tjera motorike, si dhe e motoçikletave për të cilat kërkohet leje drejtimi e kategorisë përkatëse sipas legjislacionit në fuqi;

ç) çdo shërbim tjetër turistik që nuk është pjesë e pandashme e një shërbimi udhëtimi sipas nënndarjeve "a", "b" ose "c" të këtij përkufizimi.

56. "Shitës me pakicë", në kuptim të dispozitave për paketat e udhëtimit, është tregtari, i ndryshëm nga organizatori, që shet ose ofron për shitje paketa udhëtimi të kombinuara nga organizatori.

57. "Shoqërues udhëtimi" është person i punësuar apo i kontraktuar nga një agjenci udhëtimi apo operator turistik për të drejtuar një udhëtim apo një ekskursion. Teknikisht, shoqëruesi i udhëtimit kryen vetëm shoqërimin e grupit turistik, pa ushtruar funksionin e udhërrëfyesit turistik.

58. "Shtegmbajtës" është personi i trajnuar, i cili ka përgjegjësi për administrimin dhe mirëmbajtjen e shtigjeve turistike.

59. "Shteg turistik" nënkupton një rrugë kryesisht të pashtruar dhe me një sfond natyror, e pajisur me sinjalistikën dhe me infrastrukturën tjetër të nevojshme për të mundësuar ecjen ose kalimin përgjatë apo drejt vendndodhjeve të veçanta me interes turistik, me qëllim krijimin e eksperiencave rekreative.

60. "Timeshare", i njohur, gjithashtu, si pronësi pushimesh, lejon blerësit të blejnë kohë ose kredite pushimi në njësi të strukturës akomoduese. Pronësia e pushimeve ndahet midis individëve, në bazë të kohës, me intervale javore. Ky produkt pushimi i parapaguar mundëson akomodimin për pushime të ardhshme me çmimin e sotëm.

61. "Tregtar", në kuptim të dispozitave të paketës së udhëtimit është çdo person fizik ose juridik, publik ose privat, që vepron, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një personi tjetër që vepron në emër ose për llogari të tij, për qëllime që lidhen me veprimtarinë e tij tregtare, biznesin, zanatin ose profesionin, në cilësinë e organizatorit, shitësit me pakicë ose ofruesit të shërbimeve të udhëtimit, në kontratat e rregulluara nga ky ligj.

62. "Turist" është vizitori që qëndron, të paktën për një natë, në vendin që viziton për pushim, biznes dhe qëllime të tjera.

63. "Turizëm" është tërësia e veprimtarive të personave që udhëtojnë dhe qëndrojnë, për jo më shumë se 1 vit, në vende jashtë mjedisit të tyre të zakonshëm, për pushim, biznes dhe qëllime të tjera që nuk kanë lidhje me ushtrimin e ndonjë veprimtarie të paguar në vendin që vizitohet.

64. "Turizëm i qëndrueshëm" është turizmi që përmbush nevojat e turistëve, të komuniteteve pritëse, të sipërmarrjeve turistike dhe të vendimmarrësve lokalë e qendrorë, nëpërmjet menaxhimit të burimeve turistike, ruajtjes së vlerave të vazhdueshme ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore, me qëllim që ato të mbeten po aq tërheqëse sa më parë dhe të krijohen mundësi për zhvillimin e turizmit në të ardhmen.

65. "Turizëm kombëtar" nënkupton turizmin vendas dhe turizmin në dalje.

66. "Turizëm ndërkombëtar" nënkupton turizmin në dalje dhe turizmin pritës.

67. "Turizëm në dalje" është tërësia e veprimtarive turistike të një vizitori rezident jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

68. "Turizëm në hyrje" është tërësia e veprimtarive turistike të një vizitori jo rezident në territorin e Republikës së Shqipërisë.

69. "Turizëm pritës" është tërësia e veprimtarive turistike, të vizitorëve rezidentë dhe jorezidentë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

70. "Turizëm rural", është veprimtaria turistike që zhvillohet në një mjedis fshati dhe që është e orientuar drejt përdorimit të burimeve lokale të turizmit.

71. "Turizëm shëndetësor" është një formë e veçantë e turizmit që përfshin ofrimin e shërbimeve shëndetësore, mjekësore, stomatologjike, rehabilituese, parandaluese, termale dhe të mirëqenies, të kombinuara me shërbime turistike, me qëllim ruajtjen, përmirësimin ose rikuperimin e shëndetit dhe mirëqenies së vizitorëve.

72. "Turizëm vendas" është tërësia e veprimtarive turistike të një vizitori rezident brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

73. "Udhërrëfyes turistik" është çdo person, mbi moshën 18 vjeç, i certifikuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, sipas parashikimeve të këtij ligji, i cili ofron asistencë, informacion dhe interpretime të trashëgimisë kulturore, historike e bashkëkohore për një grup të organizuar turistësh ose individë të veçantë, në një mjedis turistik, qoftë ky qytet, fshat, rrethinë me interesa të veçantë turistikë, muze apo ndërtesa të tjera me vlera edukuese, fetare, historike dhe kulturore.

74. "Udhëtar" është çdo person që lëviz ndërmjet vendeve të ndryshme, jashtë vendbanimit të zakonshëm, për arsye dhe kohëzgjatje të ndryshme. Në kuptim të dispozitave për paketat e udhëtimit, "udhëtar" është çdo person që kërkon të lidhë një kontratë ose që ka të drejtë të udhëtojë në bazë të një kontrate të mbuluar nga këto dispozita.

75. "Ujëra të brendshme" ka kuptimin e dhënë në ligjin për aktivitetet e turizmit detar.

76. "Veprimtari turistike" është tërësia e veprimtarive që zhvillohen në bazë të kërkesës dhe ofertës, në fushën e turizmit, dhe prodhon produkte karakteristike të turizmit.

77. "Vilë" është një ndërtesë me oborr dhe hapësirë kopshti, e destinuar për të ofruar shërbime akomodimi për turistët në zona turistike.

78. "Vizitor" është çdo person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendbanimi i vet i zakonshëm, për më pak se 1 vit, dhe që nuk ka si qëllim të ndërmarrë veprimtari që paguhen në vendin e vizituar.

79. "Vizitor ditor" është personi që viziton përkohësisht një vend dhe qëndron për më pak se 24 orë, me qëllimin e kalimit të kohës së lirë apo të biznesit, por jo për transit.

80. "Vrojtues plazhi" është personi i kualifikuar për të shpëtuar jetën në ujë dhe për të dhënë ndihmën e parë mjekësore.

81. "Zonë bregujore" në kuptim të këtij ligji, është hapësira tokësore përgjatë brigjeve të detit, liqeneve dhe lumenjve, e përfshirë në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, si dhe hapësira ujore e përcaktuar për zhvillimin e veprimtarive turistike, sipas zonave dhe hartave të miratuara nga organet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

82. "Zonë me përparësi zhvillimin e turizmit" është zonë me rëndësi kombëtare në fushën e turizmit, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

83. "Zyrë e informacionit turistik" është zyrë, qëllimi parësor i së cilës është t'u sigurojë turistëve informacion lidhur me udhëtimet, veprimtaritë dhe objektet turistike, aktivitetet kulturore dhe çështje të tjera, për të lehtësuar vizitën, udhëtimin apo qëndrimin e tyre.

KREU II
PARIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË TURIZMIT DHE INVESTIMET NË ZHVILLIMIN E TIJ

Neni 5
Parimet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit

1. Zhvillimi i turizmit dhe i veprimtarive të lidhura me të mbështetet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, të cilat përfshijnë dimensionin ekonomik, mjedisor dhe social-kulturor. Zbatimi i këtyre parimeve synon të sigurojë një ekuilibër të përshtatshëm ndërmjet këtyre dimensioneve, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së zhvillimit të turizmit në afatgjatë.

2. Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit zbatohen nëpërmjet:

a) përfshirjes në procesin e planifikimit të organeve publike, sektorit privat, shoqatave profesionale e tregtare, organizatave për mbrojtjen e konsumatorit, organizatave jofitimprurëse përkatëse dhe komunitetit;

b) organizimit dhe zbatimit të planifikimit turistik në nivel vendor, në përputhje me Planin Kombëtar Sektorial të Turizmit, të hartuar dhe të miratuar sipas dispozitave ligjore në fuqi, si pjesë përbërëse e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në nivel kombëtar;

c) parashikimit, planifikimit, administrimit dhe kontrollit të veprimtarive turistike, në përputhje me normat dhe standardet në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe të burimeve turistike;

ç) shpërndarjes së drejtë të përfitimeve dhe kostove ndërmjet aktorëve të sistemit turistik;

d) informimit, edukimit, motivimit dhe përfshirjes së popullsisë vendase në procesin e krijimit të vlerës turistike;

dh) vlerësimit paraprak të projekteve të turizmit dhe ndikimit të zbatimit të tyre;

e) përfshirjes së komuniteteve vendore në studimin dhe hartimin e programeve të përbashkëta për zhvillimin e turizmit;

ë) monitorimit të zbatimit të projekteve të turizmit.

Neni 6
Investimet në zhvillimin e turizmit dhe interesi publik

1. Zhvillimi i turizmit nëpërmjet investimeve vendase ose të huaja, në përputhje me këtë ligj, konsiderohet veprimtari në interes publik dhe përfiton mbështetjen dhe lehtësitë e parashikuara në kreun VI të këtij ligji, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në të.

2. Përjashtohet nga mbështetja dhe lehtësitë e parashikuara në kreun VI, të këtij ligji, çdo investitor/operator menaxhues, çdo person që është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i tij, aksionar ose ortak i investitorit / operatorit menaxhues, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse apo kontrolluese brenda tij, që është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim të produkteve të veprës penale ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit e shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

3. Për përfitimin e mbështetjes dhe të lehtësive të parashikuara në kreun VI, të këtij ligji, subjektet e përcaktuara në pikën 2 paraqesin vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose një dokument të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton se nuk ndodhen në kushtet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

KREU III
KUADRI INSTITUCIONAL DHE STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR TURIZMIN

Neni 7
Politikat shtetërore për turizmin

1. Institucionet shtetërore dhe strukturat përgjegjëse për turizmin mbështesin zhvillimin e turizmit, si një sektor prioritar, gjithëpërfshirës, ndërsektorial dhe ndërrajonal të ekonomisë, me synim rritjen e kontributit të tij në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, nëpërmjet përmbushjes së nevojave të turistëve vendas dhe të huaj për vizita, pushime, çlodhje dhe argëtim.

2. Drejtimet kryesore të politikës shtetërore në fushën e turizmit, që bazohen te parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, janë, si më poshtë:

a) njohja e turizmit si sektor prioritar i ekonomisë;

b) mbështetja e veprimtarive turistike dhe krijimi i kushteve të favorshme ligjore, ekonomike dhe strukturore për zhvillimin e tyre;

c) përcaktimi i drejtimeve prioritare për zhvillimin e turizmit në Shqipëri;

ç) krijimi i imazhit të Republikës së Shqipërisë si destinacion turistik;

d) krijimi i kushteve për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të ligjshme të turistëve e të ofruesve të shërbimeve të turizmit;

dh) garantimi i zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e turizmit;

e) mbështetja dhe bashkëpunimi i organizatave /shoqatave të turizmit në mënyrën e përcaktuar nga ligji;

ë) zhvillimi dhe mbështetja e turizmit pritës.

Neni 8
Organet përgjegjëse në fushën e turizmit

1. Organet përgjegjëse në fushën e turizmit janë:

a) ministria përgjegjëse për turizmin;

b) Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit;

c) Komiteti për të Dhënat Statistikore në Turizëm;

ç) agjencia përgjegjëse për promovimin e turizmit dhe organizimin e ngjarjeve;

d) agjencia përgjegjëse për menaxhimin e integruar të zonës bregujore;

dh) struktura përgjegjëse për inspektimin që mbulon fushën e turizmit;

e) struktura përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve në fushën e turizmit;

ë) Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike;

f) njësitë e vetëqeverisjes vendore;

g) Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit.

Neni 9

Ministria përgjegjëse për turizmin

1. Ministria përgjegjëse për turizmin ka këto detyra:

a) harton dhe bashkërendon politikat shtetërore në fushën e turizmit, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe me legjislacionin në fuqi;

b) harton Planin Kombëtar Sektorial të Turizmit dhe ia paraqet për miratim Këshillit Kombëtar të Territorit, si dhe bashkërendon zbatimin e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) harton strategjinë e zhvillimit të turizmit dhe planin e veprimit për zbatimin e saj dhe ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave;

ç) krijon, administron dhe përditëson Regjistrin Qendror të Turizmit dhe Regjistrin Kombëtar të Burimeve Turistike, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) bashkëpunon me grupet e interesit për studimin e tregut turistik, identifikimin dhe zhvillimin e burimeve e produkteve turistike, si dhe për përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut dhe kushtet e konkurrencës;

dh) mbështet financiarisht projektet që kontribuojnë në zhvillimin e turizmit, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

e) nxit mbrojtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e burimeve turistike, si dhe promovimin e produkteve turistike, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm;

ë) merr masa për nxitjen e punësimit dhe zhvillimin profesional në sektorin e turizmit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë punësimit të të rinjve;

f) nxit dhe mbështet edukimin, formimin dhe kualifikimin profesional të vazhdueshëm në fushën e turizmit, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;

g) nxit bashkëpunimin me institucionet publike dhe private për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave në fushën e turizmit;

gj) bashkërendon zbatimin e detyrimeve që rjedhin nga legjislacioni kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e turizmit, në përputhje me kompetencat e saj;

h) përfaqëson interesat e shtetit shqiptar në organizatat ndërkombëtare të turizmit dhe bashkëpunon me shtetet dhe organizatat përkatëse, në përputhje me legjislacionin dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi;

i) harton dhe zbaton politikat për sistemet e certifikimit dhe të klasifikimit në fushën e turizmit, në përputhje me këtë ligj;

j) bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare për zbatimin e programeve të asistencës dhe

të projekteve për zhvillimin e turizmit;

k) i propozon organit kompetent miratimin e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

l) bashkëpunon me autoritetet kompetente për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e turistëve;

ll) nxit zbatimin e parimeve të Kodit Global të Etikës në Turizëm;

m) harton politikat për zhvillimin e produkteve turistike, marketingun turistik dhe menaxhimin e destinacioneve, në përputhje me strategjitë përkatëse të miratuara;

n) përcakton kriteret për funksionimin e zyrave të informacionit turistik, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

nj) bashkërendon veprimtarinë me institucionet përgjegjëse për zhvillimin e infrastrukturës turistike, vendosjen e sinjalistikës turistike, mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme e të dëmtimeve në zonat turistike;

o) bashkërendon politikat për zhvillimin e produkteve turistike dhe menaxhimin e destinacioneve me institucionet dhe aktorët përgjegjës;

p) siguron bashkërendimin institucional për mbrojtjen e turistëve dhe të konsumatorëve në fushën e turizmit;

q) harton dhe zbaton programe për mbështetjen e projekteve turistike, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

r) nxit sipërmarrjet turistike, veçanërisht strukturat akomoduese, të përdorin me efikasitet burimet natyrore dhe të zbatojnë praktika të qëndrueshme, përfshirë pajisjen me "Eco-Certifikatë", sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

2. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe organizatat jofitimprurëse që veprojnë në Republikën e Shqipërisë dhe përfshihen në programe asistence të ofruara nga organizata ndërkombëtare në fushën e turizmit, njoftojnë ministrinë përgjegjëse për turizmin për veprimtaritë përkatëse, sipas formatit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin dhe të publikuar në faqen zyrtare të ministrisë.

Neni 10

Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin krijohet Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit (KKSPT), si organ këshillimor për çështjet që lidhen me zhvillimin e turizmit dhe veprimtarinë e sektorit privat në këtë fushë.

2. KKSPT kryesohet nga ministri përgjegjës për turizmin dhe përbëhet nga përfaqësues të shoqatave kombëtare të sipërmarrjeve turistike dhe të sektorëve të lidhur me turizmin, të institucioneve të arsimit të lartë, të dhomave të tregtisë, të shoqatave dhe organizatave jofitimprurëse që veprojnë në fushën e turizmit, si dhe nga përfaqësues të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare që mbështesin zhvillimin e turizmit.

3. KKSPT-ja ka këto detyra:

a) këshillon ministrin përgjegjës për turizmin për hartimin e strategjisë së zhvillimit të turizmit dhe të planit të veprimit, përpara paraqitjes së tyre për miratim;

b) shqyrton çështje që lidhen me zhvillimin e veprimtarisë turistike të sektorit privat dhe paraqet propozime për adresimin e tyre;

c) nxit bashkëpunimin ndërmjet sektorit privat dhe ministrisë përgjegjëse për turizmin për çështje që lidhen me zhvillimin e turizmit dhe zbatimin e strategjisë së zhvillimit të turizmit dhe të planit të veprimit;

ç) jep mendime dhe rekomandime për përditësimin e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit;

d) jep mendime dhe rekomandime për projektligjet dhe projektaktet nënligjore që lidhen me fushën e turizmit;

dh) i paraqet ministrisë përgjegjëse për turizmin informacion dhe rekomandime lidhur me ecurinë, problematikat dhe nevojat e sektorit privat të turizmit.

4. Rregullat për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e KKSPT miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 11

Komiteti për të dhënat statistikore në turizëm

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin krijohet Komiteti për të Dhënat Statistikore në Turizëm (KDHST), si organ koordinues për bashkëpunimin institucional në mbledhjen, shkëmbimin dhe përdorimin e të dhënave statistikore në fushën e turizmit.

2. KDHST kryesohet nga ministri përgjegjës për turizmin dhe përbëhet nga përfaqësues të institucioneve publike qendrore dhe vendore, veprimtaria e të cilave lidhet me prodhimin, mbledhjen, përpunimin ose administrimin e të dhënave në fushën e turizmit.

3. Përbërja, organizimi, funksionimi, si dhe detyrat e KDHST miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

4. Veprimtaria e KDHST zhvillohet në përputhje me legjislacionin për statistikat zyrtare, bazat e të dhënave shtetërore dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 12

Agjencia përgjegjëse për promovimin e turizmit dhe organizimin e ngjarjeve

1. Agjencia përgjegjëse për promovimin e turizmit dhe organizimin e ngjarjeve (Agjencia) është person juridik publik, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin. Agjencia ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me këtë ligj dhe financohet nga fondet e buxhetit të shtetit, të ardhurat e veta dhe burime të tjera të ligjshme.

2. Agjencia ka mision promovimin e Shqipërisë si destinacion turistik, brenda dhe jashtë vendit, si dhe mbështetjen e zhvillimit të turizmit gjatë gjithë vitit, nëpërmjet organizimit, bashkorganizimit, mbështetjes, financimit dhe promovimit të festivaleve, koncerteve, spektakleve, shfaqjeve dhe veprimtarive të tjera me interes turistik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

4. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

5. Rregullat për krijimin, administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të veta të Agjencisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin dhe ministrit përgjegjës për financat.

6. Emërimi dhe lirimi i drejtorit të përgjithshëm të agjencisë bëhet me urdhër të ministrit

përgjegjës për turizmin.

Neni 13

Funksionet dhe kompetencat e agjencisë përgjegjëse për promovimin e turizmit dhe organizimin e ngjarjeve

1. Agjencia ushtron këto funksione dhe kompetenca:

a) zbaton politikat shtetërore për marketingun dhe promovimin e turizmit, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në përputhje me strategjinë për zhvillimin e turizmit dhe dokumentet e tjera strategjike përkatëse;

b) promovon Republikën e Shqipërisë si destinacion turistik në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare, nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjes në panaire turistike ndërkombëtare, fushatave të marketingut dhe veprimtarive të tjera promovuese, me qëllim krijimin, forcimin dhe përmirësimin e imazhit të Shqipërisë si destinacion turistik;

c) siguron dhe publikon informacion për destinacionet dhe produktet turistike të Republikës së Shqipërisë, shërbimet turistike të ofruara, si dhe veprimtaritë dhe atraksionet me interes për vizitorët dhe turistët;

ç) bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore, zyrat e informacionit turistik, institucionet publike, subjektet private dhe organizatat që veprojnë në fushën e turizmit për promovimin e destinacioneve dhe produkteve turistike;

d) promovon mundësitë e investimit në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për nxitjen e investimeve;

dh) propozon, harton dhe realizon materiale dhe produkte promovuese, në përputhje me kërkesat e tregut turistik dhe dokumentet strategjike përkatëse;

e) mirëmban, përditëson dhe zhvillon kanalet dhe platformat zyrtare të komunikimit dhe promovimit turistik;

ë) propozon dhe zhvillon projekte në fushën e promovimit të turizmit dhe organizimit të ngjarjeve, në përputhje me fushën e veprimtarisë së saj dhe me miratimin paraprak të ministrisë përgjegjëse për turizmin;

f) harton, në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe vendore dhe grupet e interesit, kalendarin kombëtar të veprimtarive me interes turistik dhe bashkërendon zbatimin e tij;

g) planifikon, organizon, bashkorganizon, mbështet dhe promovon veprimtari kulturore, artistike, sportive, tradicionale dhe veprimtari të tjera me interes për turizmin, me synim tërheqjen e vizitorëve, diversifikimin e ofertës turistike dhe nxitjen e turizmit gjatë gjithë vitit;

gj) financon projekte dhe veprimtari me interes për turizmin nga fondet buxhetore të miratuara për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

h) mbledh të ardhurat që krijohen nga marrëveshjet e qirasë për sipërfaqet e dhëna në përdorim për zhvillimin e turizmit dhe i administron ato në përputhje me legjislacionin në fuqi;

i) ndjek, monitoron dhe verifikon zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese të qirasë dhe të marrëveshjeve të zhvillimit të turizmit të lidhura me subjektet që gëzojnë statusin "person i stimuluar", si dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve, kushteve, afateve dhe kritereve të përcaktuara në to, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rast të konstatimit të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore, ndërmerr veprimet e nevojshme për zbatimin e

marrëveshjeve, përfshirë kërkimin e penaliteteve kontraktore, kërkesën për përmbushjen e detyrimeve dhe ushtrimin e të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës kompetente për mbrojtjen e interesave të shtetit;

j) krijon të ardhura dytësore nga shërbimet e ofruara dhe nga pagesat për promovimin e veprimtarive në hapësirat që administron, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

k) propozon ministrit përgjegjës për turizmin ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me fushën e veprimtarisë së saj, duke paraqitur argumentet përkatëse;

l) kryen çdo funksion tjetër të përcaktuar me ligj ose me akte nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;

ll) zhvillon dhe administron platformën kombëtare digjitale të promovimit turistik dhe të informacionit për vizitorët, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

m) kryen analiza të tregut turistik, studime dhe vlerësime mbi tendencat e kërkesës turistike, sezonalitetin, konkurrueshmërinë dhe performancën e destinacioneve turistike;

n) krijon dhe administron sisteme të inteligjencës turistike dhe instrumente analitike për mbështetjen e politikave të zhvillimit, marketingut dhe promovimit të turizmit;

nj) mbështet dhe bashkërendon zhvillimin dhe menaxhimin e destinacioneve turistike në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat e menaxhimit të destinacioneve dhe aktorët e tjerë të sektorit;

o) harton dhe zbaton programe për zhvillimin, diversifikimin dhe promovimin e produkteve turistike, në përputhje me strategjitë kombëtare të turizmit;

p) zhvillon partneritete dhe programe bashkëmarketingu me operatorë turistikë, transportues, aeroporte, porte, struktura akomoduese dhe subjekte të tjera që veprojnë në sektorin e turizmit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

q) monitoron ndikimin e veprimtarive dhe eventeve me interes turistik në zhvillimin e turizmit dhe përgatit analiza e rekomandime për përmirësimin e tyre.

2. Rregullat dhe procedurat për krijimin, mbledhjen, administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të veta të agjencisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin dhe ministrit përgjegjës për financat, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 14

Agjencia përgjegjëse për menaxhimin e integruar të zonës bregujore

1. Agjencia përgjegjëse për menaxhimin e integruar të zonës bregujore (Agjencia) është person juridik publik, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin. Agjencia ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me këtë ligj dhe financohet nga fondet e buxhetit të shtetit, të ardhurat e veta dhe burime të tjera të ligjshme.

2. Agjencia ka për qëllim mbrojtjen dhe menaxhimin e integruar të zonës bregujore, përfshirë brigjet detare, liqenore dhe lumore, si dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Organizimi, funksionimi, kompetencat dhe detyrat e Agjencisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

4. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

5. Rregullat për krijimin, administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të veta të Agjencisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin dhe ministrit përgjegjës për financat.

6. Emërimi dhe lirimi i drejtorit të përgjithshëm të agjencisë bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 15

Funksionet dhe kompetencat e Agjencisë përgjegjëse për menaxhimin e integruar të zonës bregujore

1. Agjencia përgjegjëse për menaxhimin e integruar të zonës bregujore ushtron këto funksione dhe kompetenca:

a) Organizon dhe koordinon veprimtaritë që lidhen me menaxhimin e integruar të zonës bregujore;

b) Bashkëpunon me institucionet shtetërore të nivelit qendror dhe vendor, me investitorët dhe aktorët e tjerë vendas e ndërkombëtarë, me qëllim shkëmbimin e të dhënave dhe krijimin e kushteve të nevojshme për përmbushjen e objektivave dhe ushtrimin e funksioneve të saj;

c) Nxit dhe mbështet investimet në zonën bregujore;

ç) Bashkërendon programet dhe projektet zhvillimore që kanë rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregujore;

d) Siguron shërbimin e pastrimit të zonës bregdetare gjatë sezonit turistik, në mbështetje dhe plotësim të shërbimeve të ofruara nga organet kompetente të qeverisjes vendore. Procedurat e prokurimit publik për këtë shërbim zhvillohen nga agjencia në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik;

dh) Monitoron plazhet dhe stacionet e plazhit, evidenton problematikat që lidhen me administrimin, pastërtinë dhe sigurinë e pushuesve, si dhe bashkërendon me institucionet përgjegjëse marrjen e masave për zgjidhjen e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e) Krijon dhe administron sistemin kombëtar të informacionit për plazhet, stacionet e plazhit dhe aktivitetet e turizmit bregdetar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ë) Harton, administron dhe përditëson hartat tematike dhe bazat e të dhënave për përdorimin turistik të zonave bregujore, plazheve dhe stacioneve të plazhit, në bashkëpunim me institucionet kompetente;

f) Krijon dhe administron Regjistrin Kombëtar Digjital të Plazheve dhe stacioneve të plazhit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Kryen monitorimin e përdorimit turistik të zonave bregujore, plazheve dhe stacioneve të plazhit nëpërmjet sistemeve digjitale dhe mjeteve të tjera teknike të monitorimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

gj) Kryen studime, analiza dhe vlerësime për kapacitetin turistik, ngarkesën sezonale, aksesin publik, standardet e shërbimit, përdorimin e hapësirave bregdetare dhe zhvillimin e produkteve të turizmit bregdetar dhe detar;

h) Ofron asistencë teknike për njësitë e vetëqeverisjes vendore për planifikimin, organizimin, administrimin dhe menaxhimin e plazheve dhe të aktiviteteve turistike bregdetare;

i) Zhvillon dhe propozon standarde për cilësinë e shërbimeve, organizimin, menaxhimin dhe përdorimin turistik të plazheve dhe stacioneve të plazhit;

j) Bashkëpunon me universitete, institucione kërkimore dhe organizata kombëtare e ndërkombëtare për realizimin e studimeve, projekteve dhe programeve në fushën e turizmit bregdetar dhe detar;

k) Zhvillon dhe administron projekte dhe programe të financuara nga Bashkimi Europian dhe organizata të tjera ndërkombëtare në fushën e menaxhimit të zonave bregujore, turizmit bregdetar, digjitalizimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm;

l) Zhvillon programe trajnimi, standardizimi dhe certifikimi vullnetar për menaxhimin e plazheve dhe shërbimet e lidhura me turizmin bregdetar;

ll) Ushtron çdo funksion dhe përgjegjësi tjetër të përcaktuar në legjislacionin në fuqi ose në aktet nënligjore përkatëse.

Neni 16

Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit

1. Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit është në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin.

2. Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit ushtron funksionet e inspektimit në përputhje me këtë ligj, legjislacionin për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

3. Ajo mbikëqyr dhe kontrollon zbatimin e legjislacionit në fushën e turizmit, me qëllim garantimin e standardeve, sigurisë, cilësisë së shërbimeve turistike dhe mbrojtjen e interesave të turistëve dhe konsumatorëve.

4. Struktura shqyrton ankesat që lidhen me shkeljen e kërkesave dhe detyrimeve ligjore dhe merr masat administrative të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

5. Organizimi, funksionimi, struktura dhe organika e strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17

Struktura përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin krijohet Zyra për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve në fushën e turizmit (ZAM), e cila ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit.

2. ZAM-i ka si funksion kryesor trajtimin dhe zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike sipas këtij ligji, kur këto mosmarrëveshje burojnë nga ofrimi i shërbimeve turistike.

3. Në ushtrim të funksioneve dhe përgjegjësive të saj, ZAM-i:

a) Pranon dhe shqyrton kërkesat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve që lidhen me ofrimin e shërbimeve turistike;

b) Vlerëson nëse kërkesat dhe mosmarrëveshjet e paraqitura plotësojnë kushtet ligjore për t'iu nënshtruar procedurës së zgjidhjes alternative;

c) Administron dhe zhvillon procedurat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve

ndërmjet konsumatorëve dhe subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike;

ç) Kërkon nga palët çdo informacion, sqarim dhe dokumentacion të nevojshëm për shqyrtimin dhe trajtimin e mosmarrëveshjes;

d) Bashkëpunon dhe shkëmben informacion me strukturat përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit dhe me autoritetet e tjera kompetente për mbrojtjen e konsumatorit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

dh) Informon konsumatorët dhe subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike për procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, mënyrën e paraqitjes së kërkesave dhe të drejtat e detyrimet e palëve gjatë këtyre procedurave;

e) Administron dhe ruan të dhënat për kërkesat e paraqitura dhe mosmarrëveshjet e trajtuara, si dhe harton raporte periodike për veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit.

4. Procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve zhvillohen në përputhje me parimet e pavarësisë, paanshmërisë, transparencës, efektivitetit dhe trajtimit të barabartë e të drejtë të palëve. Përdorimi i këtyre procedurave nuk kufizon dhe nuk cenon të drejtën e palëve për t'iu drejtuar gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e ZAM-it, procedurat për paraqitjen, pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave, afatet përkatëse, si dhe mënyra e administrimit të të dhënave dhe e raportimit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit.

Neni 18

Komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin krijohet Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike, i përbërë nga 5 anëtarë, si strukturë përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesave për certifikimin e veprimtarive turistike.

2. Komisioni krijohet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

3. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i Komisionit, procedurat për shqyrtimin e kërkesave për certifikim, si dhe autoriteti përgjegjës për lëshimin e certifikatave përcaktohen me rregullore të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 19

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e turizmit

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në zbatim të këtij ligji, kanë këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Krijojnë dhe përditësojnë inventarin e burimeve kryesore turistike dhe inventarin e sipërmarrjeve turistike që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e njësisë përkatëse;

b) Përcjellin pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, çdo gjashtë muaj, inventarët e përshkruar në shkronjën "a" të këtij neni, me qëllim krijimin dhe përditësimin e bazës kombëtare të të dhënave për turizmin;

c) Mbështesin zhvillimin e veprimtarive turistike në nivel vendor, nëpërmjet sigurimit dhe përmirësimit të infrastrukturës mbështetëse, në përputhje me kompetencat e tyre dhe me

legjislacionin në fuqi;

ç) Nxisin zhvillimin dhe diversifikimin e produkteve turistike në nivel vendor, përfshirë turizmin kulturor, agroturizmin dhe format e tjera të turizmit, në përputhje me burimet dhe potencialet turistike të territorit, në bashkëpunim me institucionet qendrore e vendore dhe grupet e interesit;

d) Mbledhin dhe përcjellin pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin informacionin dhe të dhënat statistikore që lidhen me zhvillimin e turizmit në territorin e tyre, në përputhje me kërkesat e sistemit të statistikave të turizmit dhe legjislacionin në fuqi;

dh) Bashkëpunojnë me institucionet përgjegjëse për marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor për vizitorët dhe turistët brenda territorit të tyre, në përputhje me kompetencat përkatëse dhe standardet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi;

e) Marrin masa për mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e higjienës dhe garantimin e një mjedisi të shëndetshëm në territorin e tyre, në përputhje me normat dhe rregullat higjieno-sanitare dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 20

Komiteti rajonal i zhvillimit të turizmit

1. Pranë çdo prefekture krijohet Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit, si strukturë koordinuese për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për çështjet që lidhen me zhvillimin e turizmit. Komiteti drejtohet nga prefekti i qarkut dhe përbëhet nga përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore, të këshillit të qarkut, të shoqatave vendore që veprojnë në fushën e turizmit, të institucioneve arsimore dhe formuese në këtë fushë, si dhe të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

2. Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit ka këto detyra:

a) Shqyrton çështjet dhe problematikat që lidhen me zhvillimin e veprimtarive turistike në territorin e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe nxit bashkërendimin e masave për adresimin e tyre;

b) Nxit dhe lehtëson bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore, ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe institucioneve të tjera që veprojnë në nivel vendor, për zbatimin e politikave kombëtare dhe realizimin e objektivave për zhvillimin e turizmit;

c) Informon ministrinë përgjegjëse për turizmin për problematikat, nevojat dhe zhvillimet që lidhen me turizmin në territorin administrativ përkatës, si dhe paraqet propozime për përmirësimin e bashkëpunimit institucional dhe zhvillimin e sektorit.

3. Komiteti mblidhet të paktën dy herë në vit, si dhe sa herë që thirret nga prefekti i qarkut.

4. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për turizmin.

KREU IV
PLANIFIKIMI I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Neni 21

Parimet e planifikimit të zhvillimit të turizmit

1. Planifikimi i zhvillimit të turizmit:

a) mbështetet në të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Burimeve Turistike;

b) është pjesë përbërëse e sistemit të planifikimit të territorit dhe hartohet në përputhje me Planin e Përgjithshëm Kombëtar të Territorit, Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Turizmit, legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe legjislacionin për administrimin dhe mbrojtjen e tokës;

c) orientohet drejt zonave me potencial të lartë turistik dhe zonave ku zhvillimi i turizmit kontribuon në zhvillimin ekonomik e social të komuniteteve dhe territoreve përkatëse.

2. Planet e zhvillimit të turizmit shqyrtohen dhe rishikohen periodikisht, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së tyre me politikat kombëtare, territoriale, mjedisore dhe social-ekonomike, si dhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Neni 22

Klasifikimi i burimeve turistike

1. Burimet turistike në Republikën e Shqipërisë klasifikohen në:

a) burime natyrore turistike, ku përfshihen peizazhet natyrore, zonat e mbrojtura, veçoritë gjeografike dhe biologjike, kushtet klimatike, detare dhe hidrografike, si dhe objektet e tjera fizike, natyrore apo gjeomonumentale, me vlerë turistike;

b) burime kulturore turistike, të cilat ndahen në:

i) burime materiale kulturore turistike, ku përfshihen monumentet e kulturës, ndërtesat historike, objektet arkeologjike, reliket, veprat e artit dhe elemente të tjera të trashëgimisë materiale;

ii) burime jomateriale kulturore turistike, ku përfshihen traditat, zakonet, festat, folklori, gastronomia, veprimtaritë artistike dhe kulturore, si dhe elemente të tjera të trashëgimisë kulturore jomateriale.

2. Burimet turistike zhvillohen dhe shndërrohen në produkte turistike nëpërmjet proceseve të studimit, planifikimit dhe menaxhimit, në përputhje me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Turizmit.

Neni 23

Regjistri Kombëtar i Burimeve Turistike

1. Ministria përgjegjëse për turizmin identifikon, inventarizon dhe administron informacionin mbi burimet turistike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Ministria përgjegjëse për turizmin, në bashkëpunim me organet publike të qeverisjes qendrore dhe vendore, krijon, administron dhe përditëson Regjistrin Kombëtar të Burimeve Turistike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Pronarët, administratorët ose subjektet përgjegjëse për menaxhimin e burimeve turistike kanë detyrimin të paraqesin informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Burimeve Turistike.

4. Ministria përgjegjëse për turizmin siguron administrimin, integritetin dhe përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Burimeve Turistike.

5. Kriteret, dokumentacioni, procedurat e regjistrimit dhe të përditësimit të të dhënave, si dhe mënyra e funksionimit të Regjistrit Kombëtar të Burimeve Turistike, përcaktohen me

udhëzim të ministrit përgjegjës për turizmin.

6. Burimet turistike që janë shpallur, klasifikuar ose regjistruar nga autoritetet kompetente si pasuri kulturore, objekte ose zona arkeologjike, zona të mbrojtura, monumente natyre ose sipas kategorive të tjera të përcaktuara nga legjislacioni sektorial, regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Burimeve Turistike mbi bazën e akteve ose regjistrave zyrtarë përkatës, pa iu nënshtruar një procedure të re vlerësimi të statusit të tyre.

Neni 24

Përgjegjësia për administrimin e burimeve turistike

1. Personat juridikë dhe fizikë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, si dhe personat privatë, që zotërojnë ose administrojnë burime turistike, janë përgjegjës për mbrojtjen, ruajtjen, administrimin dhe përdorimin e tyre në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkërendojnë veprimtarinë e institucioneve publike dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në zhvillimin e turizmit brenda territorit të tyre, me qëllim mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e burimeve turistike, shndërrimin e tyre në produkte turistike dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të potencialit të tyre ekonomik, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

3. Në ushtrimin e kompetencave të tyre, njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin në konsideratë rekomandimet e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit.

Neni 25

Mbështetja për zhvillimin e turizmit

1. Organet shtetërore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për turizmin, mbështesin zhvillimin e turizmit nëpërmjet:

a) nxitjes dhe mbështetjes së planeve të zhvillimit të turizmit në nivel vendor, bazuar në studime paraprake dhe në përputhje me Planin Kombëtar Sektorial të Turizmit;

b) sigurimit dhe shpërndarjes së informacionit turistik;

c) mbështetjes së kualifikimit dhe zhvillimit profesional të burimeve njerëzore në sektorin e turizmit;

ç) promovimit të produkteve dhe destinacioneve turistike;

d) marrjes së masave për zhvillimin e infrastrukturës turistike dhe të shërbimeve publike në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit dhe në destinacionet turistike;

dh) mbështetjes së investimeve turistike në zonat malore dhe në zonat me popullsi të rrallë;

e) propozimit të masave dhe politikave mbështetëse për bizneset turistike, individët dhe personat juridikë që ushtrojnë veprimtari në zonat me rëndësi kombëtare për turizmin.

ë) nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore, sektorit privat dhe komuniteteve lokale për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.

2. Kriteret objektive për identifikimin e zonave të thella malore ose zonave me popullsi të rrallë, procedura për përcaktimin e tyre, si dhe kushtet dhe mënyra e përfitimit të masave mbështetëse sipas këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 26

Përgatitja e planit kombëtar sektorial të turizmit

Ministria përgjegjëse për turizmin, në cilësinë e autoritetit kombëtar sektorial të planifikimit, përgatit Planin Kombëtar Sektorial të Turizmit për territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe me legjislacionin sektorial që lidhet me përdorimin, administrimin dhe mbrojtjen e territorit.

Neni 27

Përmbajtja e planit kombëtar sektorial të turizmit

Plani kombëtar sektorial i turizmit përgatitet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe përmban, të paktën:

a) drejtimet kryesore të zhvillimit të turizmit dhe përcaktimin e zonave me potencial turistik;

b) vlerësimin e investimeve të planifikuara në nivel kombëtar dhe vendor, sipas periudhave të planifikimit;

c) parashikimet për zhvillimin e infrastrukturës turistike dhe të infrastrukturës mbështetëse, në përputhje me potencialin turistik, rrjetin e zonave të mbrojtura dhe objektivat e zhvillimit ekonomik e social;

ç) parashikimet për marketingun dhe promovimin turistik;

d) parashikimet për edukimin, formimin dhe kualifikimin profesional në fushën e turizmit."

Neni 28

Caktimi i zonave me përparësi zhvillimin e turizmit

1. Me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin, Këshilli i Ministrave miraton zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, si zona të rëndësisë kombëtare, në përputhje me planin e përgjithshëm kombëtar dhe planin kombëtar sektorial të turizmit.

2. Me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin, Këshilli i Ministrave mund të vendosë ndryshimin e kufijve ose heqjen nga lista e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, në rastet kur:

a) nga rishikimi periodik konstatohet se zona ka humbur karakteristikat ose potencialin për zhvillimin e turizmit;

b) me kërkesë të ministrisë përgjegjëse për sektorin përkatës, në zonën përkatëse parashikohet realizimi i projekteve, investimeve ose veprimtarive që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, i projekteve dhe investimeve me ndikim në ekonominë lokale ose kombëtare, që mbështesin zhvillimin strategjik të sektorëve prioritarë ose që kanë rëndësi kombëtare.

3. Kriteret, rregullat dhe procedurat për rishikimin, ndryshimin e kufijve ose heqjen e statusit të zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, përfshirë dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën e vlerësimit të propozimeve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 29

Standardizimi dhe administrimi i shtigjeve turistike

1. Shtigjet turistike projektohen, hapen, regjistrohen, kategorizohen, pajisen me sinjalistikë, mirëmbahen dhe administrohen në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. Pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin ngrihet Komisioni Kombëtar i Shtigjeve Turistike, i cili shqyrton dhe miraton shtigjet turistike kombëtare dhe ushtron funksione këshillimore dhe teknike për çështjet që lidhen me standardizimin dhe administrimin e shtigjeve turistike.

3. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i Komisionit Kombëtar të Shtigjeve Turistike përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

4. Anëtarët e Komisionit Kombëtar të Shtigjeve Turistike përfitojnë shpërblim për pjesëmarrjen në mbledhjet e Komisionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore.

5. Kushtet, kriteret dhe procedurat për regjistrimin dhe kategorizimin e shtigjeve turistike, standardet e projektimit, hapjes, sinjalistikës dhe mirëmbajtjes së tyre, rregullat për administrimin e të dhënave, publikimin dhe ndërhyrjet në shtigje, detyrimet e organeve përgjegjëse, trajnimin e shtegmbajtësve, si dhe çështje të tjera që lidhen me funksionimin dhe administrimin e shtigjeve turistike, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 30

Mbrojtja, ruajtja, përdorimi dhe zhvillimi i burimeve natyrore turistike

1. Zhvillimi dhe operimi i sipërmarrjeve turistike, përfshirë hotelet, komplekset turistike dhe strukturat e tjera akomoduese, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, kryhet në përputhje me Planin Kombëtar Sektorial të Turizmit, planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura, dokumentet e planifikimit të territorit dhe legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

2. Zhvillimi dhe operimi i sipërmarrjeve turistike në pronat shtetërore që ndodhen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit lejohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, me kusht që strukturat, ndërtimet, mjediset dhe shërbimet ndihmëse të mos dëmtojnë vlerat natyrore, mjedisore dhe kulturore të zonës dhe të jenë në përputhje me Planin Kombëtar Sektorial të Turizmit dhe dokumentet e planifikimit të territorit.

3. Përdorimi dhe shfrytëzimi i burimeve natyrore turistike, përfshirë detin, liqenet, lumenjtë dhe brigjet e tyre, kryhet në mënyrë që të garantohet ruajtja e karakteristikave natyrore dhe mjedisore të tyre, si dhe mbrojtja e territorit përreth.

Neni 31

Plani i zonave me përparësi zhvillimin e turizmit

1. Ministria përgjegjëse për turizmin përgatit planet e zhvillimit për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në bashkëpunim me ministritë përgjegjëse, organet publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe grupet e interesit, dhe i paraqet për miratim sipas legjislacionit në fuqi

për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

2. Planet e detajuara për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit hartohen sipas përcaktimeve të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territori dhe rregullores përkatëse të planifikimit dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

3. Ministria përgjegjëse për turizmin, në cilësinë e autoritetit të planifikimit, zbaton instrumentet për drejtimin e zhvillimit, sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

4. Planet e zhvillimit të zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, përveç sa është parashikuar në rregulloren e planifikimit, përmbajnë edhe:

a) identifikimin, vlerësimin dhe klasifikimin e burimeve turistike të disponueshme në këto zona;

b) analizimin e mjedisit ekzistues turistik dhe të potencialit të tij, përfshirë mjedisin natyror, të biodiversitetit, të peizazhit dhe të rrjetit të zonave të mbrojtura, si dhe mjedisin kulturor, ekonomik e social;

c) përcaktimin e prioriteteve në zhvillimin e zonave përkatëse;

ç) përcaktimin dhe përshkrimin e zonave të planifikuara për turizëm, të rrjetit të zonave të mbrojtura dhe të nevojave të tyre për zhvillim turistik, brenda zonave me përparësi zhvillimin e turizmit;

d) infrastrukturën e nevojshme për sistemin e ujësjellësit, sistemin e kanalizimeve, furnizimit me energji, internet, mjediset publike dhe shërbimet turistike, që kërkohen për përmirësimin e potencialit turistik të zonave me përparësi zhvillimin e turizmit;

dh) planifikimin e sinjalistikës, stendat dhe afishimeve turistike, në bashkërendim me organet publike përgjegjëse;

e) përcaktimin e mjeteve të mbrojtjes dhe të promovimit të produkteve turistike me vlerë trashëgimie kulturore, historike ose natyrore dhe specifikimin e formave dhe mekanizmave të nevojshëm të bashkëpunimit dhe të bashkë-rendimit me autoritetet kompetente, për të arritur këtë objektiv;

ë) përcaktimin e mjeteve të nxitjes dhe promovimit të turizmit pritës dhe identifikimin e programeve të qarta të punës për ta realizuar këtë;

f) përcaktimin e mjeteve të zhvillimit dhe të mbështetjes së produkteve të turizmit në të gjitha format e tyre;

g) përcaktimin e nevojave për financim, me qëllim zbatimin e planeve dhe programeve të zhvillimit turistik;

gj) përcaktimin e burimeve të nevojshme njerëzore për zbatimin e planeve dhe programeve të zhvillimit;

h) parashikimin për monitorimin e zbatimit të planit kombëtar sektorial të turizmit dhe ndjekjen e vlerësimit të performancës në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

Neni 32

Pezullimi sezonal i punimeve të ndërtimit dhe aktiviteteve të lidhura me to në zonat turistike

1. Me qëllim garantimin e mbarëvajtjes së sezonit turistik, Këshilli i Ministrave mund të vendosë pezullimin e punimeve të ndërtimit në zona turistike gjatë periudhave të caktuara të vitit. Pezullimi mund të shtrihet edhe mbi aktivitete të tjera të lidhura me punimet e ndërtimit, kur ato zhvillohen në zonat që i nënshtrohen pezullimit dhe ndikojnë në veprimtarinë turistike.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave për pezullimin sezonal përcakton:

a) zonat që i nënshtrohen pezullimit;

b) llojet e punimeve dhe aktiviteteve që i nënshtrohen pezullimit;

c) periudhën e fillimit dhe të përfundimit të pezullimit, duke marrë në konsideratë fluksin turistik dhe karakteristikat e sezonit turistik;

ç) mënyrën e zbatimit të pezullimit, përfshirë rastet kur ai zbatohet vetëm gjatë orareve të caktuara.

3. Periudha e pezullimit sipas këtij neni nuk llogaritet në afatin e realizimit të punimeve ose të ushtrimit të aktivitetit të lejuar. Afati i lejes së ndërtimit ose i lejes për ushtrimin e aktivitetit zgjatet për një periudhë të barabartë me kohëzgjatjen e pezullimit.

KREU V
MBËSHTETJA FINANCIARE E PROJEKTEVE NË FUSHËN E TURIZMIT

Neni 33
Financimi i projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit

1. Ministria përgjegjëse për turizmin dhe Agjencia përgjegjese për promovimin dhe organizimin e ngjarjeve, brenda fondeve buxhetore të miratuara për këtë qëllim, mund të financojnë ose bashkëfinancojnë:

a) projekte të paraqitura nga persona fizikë, juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre fushën e turizmit;

b) projekte dhe veprimtari në fushën e turizmit, që konsiderohen të rëndësishme për zhvillimin dhe promovimin e turizmit dhe që kanë një buxhet që arrin mbi 50% të fondit vjetor për projekte;

c) projekte dhe veprimtari të iniciuara nga vetë ministria përgjegjëse për turizmin ose nga Agjencia përgjegjese për promovimin dhe organizimin e ngjarjeve, në përputhje me objektivat e politikave publike në fushën e turizmit.

2. Procedurat e përzgjedhjes dhe financimit të projekteve sipas këtij neni nuk përbëjnë procedura prokurimi publik dhe rregullohen sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3. Financimi ose bashkëfinancimi mund të mbulojë deri në 100 për qind të kostove të miratuara të projektit ose veprimtarisë, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

4. Procedurat dhe kriteret që ndiqen për financimin e projekteve, sipas shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 34
Miratimi i projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit nga ministria përgjegjëse për turizmin

1. Projektet dhe veprimtaritë që financohen sipas nenit 33 të këtij ligji miratohen nga ministri përgjegjës për turizmin, me propozimin e një kolegjiumi vlerësimi.

2. Kolegjiumi i vlerësimit përbëhet nga 5 nëpunës të ministrisë përgjegjëse për turizmin, të caktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

3. Kriteret, afatet dhe procedurat për paraqitjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për mbështetje financiare sipas shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 33 të këtij ligji, si dhe procedurat për miratimin e projekteve dhe veprimtarive sipas shkronjës "c" të po kësaj pike, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 35

Kompetencat e kolegjiumit në ministrinë përgjegjëse për turizmin

1. Kolegjiumi ka këto kompetenca:

a) shqyrton, vlerëson, rendit dhe përzgjedh projektet dhe veprimtaritë që kërkojnë mbështetje financiare, bazuar në vlerat e tyre promovuese, sociale dhe ekonomike në funksion të zhvillimit të turizmit;

b) propozon pranë ministrit përgjegjës për turizmin projekte dhe veprimtari në fushën e turizmit, në përputhje me nenin 33 të këtij ligji;

c) propozon pranë ministrit përgjegjës për turizmin organizimin e veprimtarive promovuese kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e turizmit.

2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të kolegjiumit përcaktohet në rregulloren e miratuar nga ministri përgjegjës për turizmin.

Neni 36

Miratimi i projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit nga Agjencia përgjegjëse për promovimin dhe organizimin e ngjarjeve

1. Projektet dhe veprimtaritë në fushën e turizmit, që janë në përputhje me kalendarin turistik të aktiviteteve zbavitëse, miratohen me urdhër të titullarit të agjencisë përgjegjëse për promovimin dhe organizimin e ngjarjeve, pas propozimit të kolegjiumit të agjencisë.

2. Kriteret, afatet dhe procedurat për paraqitjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për mbështetje financiare, si dhe procedurat për miratimin e projekteve dhe veprimtarive sipas këtij neni, përcaktohen me rregullore të miratuar nga ministri përgjegjës për turizmin.

Neni 37

Kolegjiumi i vlerësimit në Agjencinë përgjegjëse për promovimin dhe organizimin e ngjarjeve

1. Pranë Agjencisë përgjegjëse për promovimin dhe organizimin e ngjarjeve ngrihet kolegjiumi i vlerësimit.

2. Kolegjiumi përbëhet nga jo më pak se 3 punonjës të agjencisë, të caktuar me urdhër të titullarit.

3. Kolegjiumi ka këto kompetenca:

a) shqyrton, vlerëson, përzgjedh dhe rendit projektet dhe veprimtaritë që kërkojnë mbështetje financiare, bazuar në vlerat e tyre promovuese, sociale dhe ekonomike në funksion të zhvillimit të turizmit;

b) propozon pranë titullarit të agjencisë projektet dhe veprimtaritë për financim;

c) propozon organizimin e veprimtarive promovuese kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e turizmit.

4. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të kolegjiumit përcaktohet me rregullore të miratuar nga ministri përgjegjës për turizmin.

KREU VI
INVESTIMET NË TURIZËM

Neni 38
Format e partneritetit

1. Në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, organet e qeverisjes qendrore mund të marrin rolin e zhvilluesit, të përfshihen në partneritete publiko-private, të përfaqësohen me aksione në sipërmarrje turistike, të vërë në dispozicion pasuri të paluajtshme, si dhe të sigurojë infrastrukturë mbështetëse, përfshirë kombinime të këtyre formave, në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës së ndershme, proporcionalitetit dhe barazisë së trajtimit.

2. Format, kriteret, kushtet, dokumentacioni dhe procedurat për realizimin e partneriteteve në fushën e turizmit rregullohen sipas legjislacionit të posaçëm për partneritetet publiko-private dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

3. Kushtet dhe kriteret bëhen publike paraprakisht, formulohen në mënyrë të qartë, objektive, transparente dhe të aksesueshme për subjektet e interesuara.

Neni 39
Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin, i jep statusin e veçantë "Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special" subjektit që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) është investitor në një strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje në Republikën e Shqipërisë, që ndërtohet sipas parashikimeve të nenit 46 të këtij ligji dhe që plotëson kriteret dhe kushtet për t'u certifikuar sipas parashikimeve të nenit 47 të këtij ligji.

b) vlera e investimit është jo më pak se 8 (tetë) milionë euro për ndërtimin e strukturës akomoduese me 4 yje dhe jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) milionë euro për ndërtimin e strukturës akomoduese me 5 yje.

Neni 40
Paraqitja e kërkesës për statusin "Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special" dhe marrëveshja me investitorin

1. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për paraqitjen e kërkesës dhe përfitimin e statusit "Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special" përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

2. Subjektet, që përfitojnë statusin "Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status

special", nënshkruajnë marrëveshje zhvillimi me ministrinë përgjegjëse për turizmin.

Neni 41

Pasuritë e paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit

1. Pasuritë e paluajtshme në pronësi të shtetit, të ndodhura në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, me përjashtim të zonave të mbrojtura dhe objekteve të trashëgimisë kulturore kalojnë në administrim të ministrisë përgjegjëse për turizmin, me vendim të Këshillit të Ministrave, brenda 2 muajve nga miratimi i zonës përkatëse.

2. Pasuritë e paluajtshme shtetërore në administrim të njësive të vetëqeverisjes vendore, të ndodhura në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, mund të kalojnë në administrim të ministrisë përgjegjëse për turizmin me vendim të Këshillit të Ministrave, brenda 2 muajve nga miratimi i zonës përkatëse.

3. Këshilli i Ministrave, rast pas rasti, miraton me vendim transferimin, në favor të shtetit, të pasurive të paluajtshme në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, që ndodhen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

4. Për pasuritë e paluajtshme që ndodhen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, për të cilat nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar, procedurat e regjistrimit kryhen me përparësi, brenda 3 muajve nga miratimi i zonës.

Neni 42

Vënia në dispozicion e pasurive të paluajtshme shtetërore

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin, miraton vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për realizimin e projekteve investuese në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

2. E drejta e përdorimit të pasurive të paluajtshme shtetërore mund të jepet për një afat deri në 99 vjet.

3. Vënia në dispozicion e pasurive të paluajtshme shtetërore mund të bëhet edhe nëpërmjet kontratës simbolike 1 euro, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Kushtet, kriteret, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Për investitorët me status "Investitor Strategjik i Veçantë", sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike, Këshilli i Ministrave mund të vendosë, rast pas rasti, transferimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore në favor të investitorit, pasi të jetë realizuar investimi i plotë. Kur vlerësohet e nevojshme nga Këshilli i Ministrave, marrëveshja për realizimin e investimit strategjik i propozohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për miratim me ligj të posaçëm.

Neni 43

Marrëveshja me investitorin

1. Ministria përgjegjëse për turizmin nënshkruan marrëveshje zhvillimi me investitorët që realizojnë investime në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

2. Marrëveshja e zhvillimit përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve, karakteristikat e

projektit, afatet e realizimit, vlerën e investimit, garancitë përkatëse, si dhe instrumentet e nevojshme për sigurimin e realizimit të investimit.

3. Procedurat dhe formatin e marrëveshjes së zhvillimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 44

Të drejtat dhe detyrimet e investitorit në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit

1. Investitori është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet dhe të sigurojë garancitë e përcaktuara në marrëveshjen e zhvillimit të nënshkruar me ministrinë përgjegjëse për turizmin.

2. Investitori ka të drejtë të zgjedhë format e administrimit dhe të ofrimit të produkteve turistike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Investitori ka të drejtë të nënkontraktojë ndërtimin e strukturave, administrimin e sipërmarrjes, apo pjesëve të saj, me kusht që objekti i investimit dhe i veprimtarisë të mbetet i pandryshuar. Nënkontraktimi nuk e çliron investitorin nga përgjegjësia për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjen e zhvillimit.

4. Investitori mund të transferojë pronësinë e strukturave të veçanta akomoduese te të tretët vetëm këto janë parashikuar dhe identifikuar në mënyrë të detajuar në projektin e investimit dhe në marrëveshjen e zhvillimit të turizmit.

5. Për strukturat e ndërtuara mbi pasuri të paluajtshme shtetërore të vëna në dispozicion të investitorit sipas këtij ligji, transferimi i së drejtës së pronësisë ose i të drejtave të tjera reale mbi to te të tretët nuk lejohet.

6. Transferimi i veprimtarisë, i projektit të investimit ose i një pjese të aksioneve apo pjesëmarrjeve te të tretët lejohet vetëm me miratimin paraprak të ministrit përgjegjës për turizmin dhe me kusht që objekti i investimit dhe i veprimtarisë të mbetet i pandryshuar.

7. Dokumentacioni, kushtet, kriteret, afatet dhe procedurat për shqyrtimin e kërkesës dhe dhënien e pëlqimit paraprak për transferimin e veprimtarisë, të projektit të investimit ose të aksioneve apo pjesëmarrjeve, përfshirë verifikimin e kapaciteteve financiare dhe teknike të përfituesit të transferimit, vazhdimësinë e përmbushjes së detyrimeve kontraktore dhe ruajtjen e objektit të investimit, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 45

Pasojat e mospërmbushjes së marrëveshjes së zhvillimit

1. Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve ose të shkeljes së kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e zhvillimit, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për turizmin, mund të shfuqizojë të drejtën e vënies në dispozicion të pasurisë së paluajtshme shtetërore.

2. Para marrjes së vendimit për shfuqizimin, investitorit i jepet një afat i arsyeshëm për paraqitjen e shpjegimeve dhe, kur natyra e shkeljes e lejon, për marrjen e masave korrigjuese për përmbushjen e detyrimeve të marrëveshjes.

3. Me shfuqizimin e së drejtës së vënies në dispozicion, pasuria e paluajtshme shtetërore rikthehet në administrimin dhe disponimin e shtetit, së bashku me të drejtat dhe kufizimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe nga marrëveshja e zhvillimit.

4. Kur investimi nuk është realizuar në përputhje me marrëveshjen e zhvillimit ose kur vazhdimi i tij nuk i shërben interesit publik, ministria përgjegjëse për turizmin mund t'i kërkojë investitorit rikthimin e pasurisë në gjendjen e mëparshme, përfshirë prishjen e ndërtimeve, largimin e instalimeve dhe rehabilitimin e mjedisit, brenda afateve të përcaktuara në vendimin e shfuqizimit ose në marrëveshjen e zhvillimit.

5. Në rast se investitori nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, organet kompetente kryejnë veprimet e nevojshme për prishjen, pastrimin, rehabilitimin dhe rikthimin e pasurisë në gjendjen e mëparshme, me shpenzimet e investitorit, të cilat mbulohen nga garancitë financiare të vendosura sipas marrëveshjes së zhvillimit ose kërkohen sipas legjislacionit në fuqi.

6. Kur strukturat e ndërtuara ose investimet e kryera mund të përdoren për interes publik, turistik, ekonomik ose social dhe nuk cenojnë legjislacionin në fuqi, Këshilli i Ministrave mund të vendosë ruajtjen e tyre dhe kalimin në administrim ose pronësi shtetërore, sipas legjislacionit përkatës dhe kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e zhvillimit.

7. Marrëveshja e zhvillimit parashikon garancitë financiare, masat siguruese, penalitetet dhe mekanizmat e kompensimit për mbrojtjen e interesit publik, mbulimin e kostove të rehabilitimit dhe mbrojtjen e të drejtave të të tretëve.

KREU VII
STRUKTURAT AKOMODUESE

Neni 46
Kategorizimi i strukturave akomoduese

1. Çdo sipërmarrës turistik që regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin kërkesën për pajisje me certifikatë kategorizimi, brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit, sipas kushteve, kritereve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave të parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

2. Çdo subjekt zhvillues, përpara miratimit të lejes së ndërtimit për strukturë akomoduese nga organi përgjegjës, pajiset nga ministria përgjegjëse për turizmin me certifikatë paraprake kategorizimi. Certifikata lëshohet mbi bazën e projektit të paraqitur, pas verifikimit të përputhshmërisë së tij me kushtet dhe kriteret për projektimin dhe ndërtimin, për kategorinë përkatëse të strukturës akomoduese, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave të parashikuar në pikën 3 të këtij neni. Certifikata paraprake e kategorizimit nuk zëvendëson certifikatën e kategorizimit të strukturës akomoduese.

3. Kategoritë e strukturave akomoduese, kushtet dhe kriteret për projektimin dhe ndërtimin e tyre, si dhe kushtet, kriteret dhe procedurat për lëshimin e certifikatës paraprake të kategorizimit dhe të certifikatës së kategorizimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

4. Certifikata e kategorizimit regjistrohet në Regjistrin Qendror të Turizmit, që administrohet nga ministria përgjegjëse për turizmin, dhe është e vlefshme pa afat, për aq kohë sa struktura përmbush kushtet dhe kriteret e kategorizimit.

5. Çdo strukturë akomoduese, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, ka detyrimin të kryejë regjistrimin elektronik të klientëve për qëllime të administrimit të veprimtarisë turistike,

prodhimit të statistikave zyrtare dhe përmbushjes së detyrimeve ligjore, me të dhënat për numrin e vizitorëve, netët e qëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën. Përpunimi, ruajtja, transmetimi dhe mbrojtja e këtyre të dhënave kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Strukturat akomoduese dhe subjektet që ofrojnë shërbime ushqimi ose pijeje kanë detyrimin të grumbullojnë dhe depozitojnë mbetjet e krijuara nga veprimtaria e tyre vetëm në vendet e përcaktuara nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Njësia e vetëqeverisjes vendore përcakton vendet e grumbullimit dhe miraton rregullat për zbatimin e kësaj pike, duke garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e përvojës turistike.

Neni 47

Klasifikimi i strukturave akomoduese

1. Çdo sipërmarrje turistike, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, duhet të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin kërkesën për pajisjen me certifikatë klasifikimi sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Certifikata e klasifikimit lëshohet pa afat vlefshmërie dhe mbetet në fuqi për sa kohë struktura akomoduese përmbush kriteret dhe standardet mbi bazën e të cilave është klasifikuar.
3. Strukturat akomoduese i nënshtrohen rivlerësimit të klasifikimit çdo 5 (pesë) vjet, me qëllim verifikimin e përmbushjes së kritereve dhe standardeve përkatëse. Rivlerësimi kryhet nga ministria përgjegjëse për turizmin, sipas procedurave të përcaktuara në aktet nënligjore. Përfundimi i afatit pesëvjeçar nuk sjell automatikisht përfundimin e vlefshmërisë së certifikatës së klasifikimit.

4. Riklasifikimi i strukturës akomoduese, me qëllim ngritjen e nivelit të klasifikimit, bëhet me kërkesë të subjektit.
5. Kushtet, kriteret, tarifat, afatet, si dhe procedura për klasifikimin dhe rivlerësimin e strukturave akomoduese, përcaktohen me rregulloren përkatëse, që miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.
6. Ministria përgjegjëse për turizmin, për hartimin e rregullores dhe klasifikimin e strukturave akomoduese, mund të bashkëpunojë me agjenci, organizata dhe ekspertë vendas e ndërkombëtarë, që kanë përvojë dhe ekspertizë të dëshmuar në fushën e turizmit dhe të klasifikimit të strukturave akomoduese.
7. Kostoja e procesit të klasifikimit mbulohet nga sipërmarrjet turistike që certifikohen.
8. Certifikata e klasifikimit regjistrohet automatikisht, pas përfundimit të procesit të klasifikimit në Regjistrin Qendror të Turizmit, që administrohet nga struktura përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.
9. Për çdo ndryshim të të dhënave të deklaruara, sipërmarrja turistike që ushtron veprimtarinë e saj në fushën e strukturave akomoduese, duhet të njoftojë strukturën përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, brenda 7 ditëve pune.

Neni 48

Regjistrimi i njësive akomoduese për qëndrime afatshkurtra

1. Njësitë akomoduese për qëndrime afatshkurtra regjistrohen, përpara fillimit të ushtrimit të

veprimtarisë, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania dhe pajisen me kod unik regjistrimi. Regjistrimi kryhet për çdo njësi akomoduese, pavarësisht nëse administrohet individualisht ose si pjesë e njësive akomoduese të menaxhuara.

2. Kodi unik i regjistrimit është i detyrueshëm të afishohet në çdo ofertë, reklamë ose publikim të njësisë akomoduese për qëndrime afatshkurtra, përfshirë platformat elektronike të ndërmjetësimit dhe rezervimit.

3. Rregullat dhe procedurat e regjistrimit, dokumentacioni i nevojshëm, standardet minimale që duhet të përmbushin këto njësi, mënyra e pajisjes me kodin unik të regjistrimit, si dhe rastet e pezullimit ose çregjistrimit të regjistrimit, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 49

Agroturizmi

1. Subjekti për të ushtruar veprimtarinë e agroturizmit plotëson kriteret për:

a) fermat e lidhura me veprimtarinë e agroturizmit;

b) strukturën pritëse të ndërtuar ose të asaj që parashikohet të ndërtohet;

c) ofrimin e ushqimeve dhe pijeve të përgatitura me ingredientë që vijnë nga vetë ferma ose nga prodhuesit lokalë;

ç) ofrimin e aktiviteteve argëtuese/edukative.

2. Veprimtaria e agroturizmit certifikohet nga ministria përgjegjëse për turizmin, nëpërmjet certifikatës paraprake për ndërtimin e agroturizmit dhe certifikatës për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit.

3. Kriteret, dokumentacioni dhe procedurat për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij, për pezullimin ose heqjen e certifikatës së veprimtarisë së agroturizmit, si dhe modeli i certifikatës miratohen nga Këshilli Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin dhe të ministrit përgjegjës për zhvillimin rural.

Neni 50

Ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë së strukturës akomoduese

1. Sipërmarrja turistike, që ushtron veprimtarinë e saj në fushën e strukturave akomoduese, e humbet të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë:

a) me përfundimin e aktivitetit si person fizik/juridik;

b) kur i hiqet kjo e drejtë me vendim të komisionit të standardizimit të veprimtarive turistike, pasi nuk plotëson kushtet dhe kriteret e nivelit më të ulët të sistemit të klasifikimit;

c) sipas përcaktimeve të tjera të bëra në këtë ligj.

KREU VIII

AGJENCITË E UDHËTIMIT DHE OPERATORËT TURISTIKË

Neni 51

Agjencia e udhëtimit

Shërbimet e agjencisë së udhëtimit përfshijnë, por nuk kufizohen me:

a) shitjen e biletave të avionit, të tragetit, të trenit, të autobusit;

b) shitjen e paketave të udhëtimit, në emër të operatorëve turistikë, vendas ose ndër-kombëtarë;

c) dhënien e automjeteve me qira, në emër të përfaqësuesve të automjeteve me qira;

ç) përgatitjen e dokumenteve të udhëtimit, në përputhje me rregullat në fuqi;

d) dhënien e informacionit dhe asistencës për përmbushjen e kërkesave shëndetësore të nevojshme për udhëtimin;

dh) dhënien e informacionit dhe asistencës për procedurat e pajisjes me viza dhe dokumente të tjera të nevojshme për hyrjen në një shtet të caktuar;

e) përgatitjen e të gjitha dokumenteve të nevojshme për transportin dhe/ose akomodimin e udhëtarëve;

f) ndërmjetësimin dhe rezervimin e shërbimeve turistike dhe të udhëtimit.

Neni 52

Licencimi dhe rregullat për ushtrimin veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit

1. Agjencia e udhëtimit, para fillimit të ushtrimit të kësaj veprimtarie, pajiset me licencë, sipas procedurës së përcaktuar ligjin për licencat, autorizimet dhe lejet.

2. Agjencia e udhëtimit duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me objekt veprimtarie si agjenci udhëtimi;

b) përfaqësuesi ligjor të mos jetë një person i dënuar me vendim të formës së prerë për veprën penale të mashtrimit, të mospagimit të taksave dhe tatimeve, të korrupsionit, apo për një vepër penale kundër moralit dhe dinjitetit të personit, brenda një periudhe 5-vjeçare, që i paraprin kërkesës për licencë;

c) përfaqësuesi ligjor, administratori ose drejtuesi teknik të ketë përfunduar të paktën arsimin e mesëm;

ç) të disponojë një adresë ushtrimi veprimtarie dhe mjetet e nevojshme teknike për ofrimin e shërbimeve.

3. Kërkesat dhe kriteret specifike, kushtet teknike dhe profesionale, dokumentacioni përkatës, si dhe rregullat për pezullimin dhe revokimin e licencës së agjencisë së udhëtimit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë. Kërkesat dhe kriteret duhet të jenë objektive, të qarta, transparente dhe proporcionale. Kontrolli i përmbushjes së tyre kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin.

4. Pas publikimit të licencës në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, ministria përgjegjëse për turizmin bën regjistrimin e kësaj licence në Regjistrin Qendror të Turizmit.

5. Çdo ndryshim i të dhënave mbi bazën e të cilave është lëshuar licenca njoftohet sipas legjislacionit në fuqi dhe pasqyrohet në Regjistrin Qendror të Turizmit.

Neni 53

Rregullat për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit të krijuar në një nga Palët e CEFTA-s

1. Një agjenci udhëtimi e krijuar ose që ofron shërbime në mënyrë të ligjshme në cilëndo nga Palët e CEFTA-s, në përputhje me ligjet, rregulloret dhe procedurat administrative të saj, mund të ofrojë shërbime të përkohshme në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me nenin 8 të Protokollit Shtesë 6 dhe Vendimin e Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s "Për lehtësimin e tregtisë së shërbimeve të ofruara nga agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë", të ratifikuar me ligjin nr. 6/2026.

2. Për ushtrimin e aktivitetit sipas pikës 1 dorëzohet deklaratë paraprake pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Deklarimi kryhet, kur është teknikisht e mundur, në mënyrë elektronike dhe regjistrohet në regjistrin përkatës.

3. Autoriteti kompetent verifikon nëse subjekti është i krijuar ose ushtron ligjërisht veprimtarinë në Palën e origjinës. Refuzimi ose ndalimi i ofrimit të shërbimit lejohet vetëm mbi baza të përcaktuara shprehimisht në ligj ose në angazhimet e zbatueshme të CEFTA-s dhe duhet të jetë i arsyetuar, objektiv dhe proporcional.

4. Kushtet, kriteret, dokumentet, forma e deklaratës, mënyra e verifikimit, regjistrimit dhe shkëmbimit të informacionit miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për turizmin dhe ministrit pergjegjës për ekonominë.

Neni 54

Ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit

Shfuqizimi i licencës dhe ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 55

Operatori turistik

Operatori turistik e bën shitjen e produkteve të veta turistike, kryesisht, nëpërmjet agjencive të udhëtimit, pa u kufizuar edhe me shitjen e drejtpërdrejtë te konsumatori. Ai nënshkruan kontrata të drejtpërdrejta me furnizuesit e shërbimeve turistike, duke i parablerë këto shërbime.

Neni 56

Licencimi dhe rregullat për ushtrimin e veprimtarisë së operatorëve turistikë

1. Operatori turistik, para fillimit të ushtrimit të kësaj veprimtarie, pajiset me licencë, sipas procedurës së përcaktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

2. Operatori turistik duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me objekt veprimtarie si operator turistik;

b) përfaqësuesi ligjor të mos jetë një person i dënuar me vendim të formës së prerë për veprën

penale të mashtrimit, të mospagimit të taksave dhe tatimeve, të korrupsionit, apo për një vepër penale kundër moralit dhe dinjitetit të personit, brenda një periudhe 5-vjeçare, që i paraprin kërkesës për licencë;

c) përfaqësuesi ligjor, administratori dhe drejtuesi teknik të zotërojnë një diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve, ose të ketë mbaruar shkollën e mesme profesionale në përputhje me objektin e veprimtarisë së biznesit dhe të kenë një eksperiencë të mëparshme në këtë fushë;

ç) të zotërojë një mjedis pune jo më të vogël se 16 m2 për ushtrimin e veprimtarisë.

3. Kërkesat dhe kriteret specifike, kushtet teknike dhe profesionale për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit turistik, dokumentacioni përkatës, si dhe rregullat për pezullimin dhe revokimin e licencës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë. Kërkesat dhe kriteret duhet të jenë objektive, të qarta, transparente, proporcionale dhe jodiskriminuese. Kontrolli i përmbushjes së tyre kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin.

4. Pas publikimit të licencës në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, ministria përgjegjëse për turizmin bën regjistrimin e kësaj licence në Regjistrin Qendror të Turizmit.

Neni 57

Rregullat për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit turistik të krijuar në një nga Palët e CEFTA-s

1. Një operator turistik i krijuar ose që ofron ligjërisht shërbime si operator turistik në cilëndo nga Palët e CEFTA-s mund të ofrojë shërbime të përkohshme në Republikën e Shqipërisë në përputhje me nenin 8 të Protokollit Shtesë 6 dhe Vendimin e Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s "Për lehtësimin e tregtisë së shërbimeve të ofruara nga agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë", të ratifikuar me ligjin nr. 6/2026.

2. Për ushtrimin e aktivitetit sipas pikës 1 dorëzohet deklaratë paraprake pranë autoritetit kompetent të përcaktuar me akt nënligjor. Deklarimi kryhet, kur është teknikisht e mundur, në mënyrë elektronike dhe regjistrohet në regjistrin përkatës.

3. Autoriteti kompetent verifikon ligjshmërinë e ushtrimit të veprimtarisë në Palën e origjinës. Refuzimi ose ndalimi lejohet vetëm mbi baza ligjore, objektive dhe proporcionale.

4. Kushtet, kriteret, dokumentet minimale, forma e deklaratës, mënyra e verifikimit, regjistrimit dhe shkëmbimit të informacionit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për turizmin dhe ministrit përgjegjës për ekonominë.

Neni 58

Ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë së operatorit turistik

Shfuqizimi i licencës dhe ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë së operatorit turistik bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 59

Regjistrimi i udhëtimeve

1. Agjencia e udhëtimit dhe operatorët turistikë mbajnë regjistër me të dhënat e turistëve, destinacionet e vizituara dhe ditët e qëndrimit dhe i raporton këto të dhëna elektronikisht, një herë në muaj, sipas formularit të miratuar nga ministri përgjegjës për turizmin.

2. Një agjenci udhëtimi ose operator turistik duhet t'i ruajë këto raportime, të specifikuara, për tre vjet, nga data e kthimit nga udhëtimi përkatës. Të dhënat mblidhen, përpunohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 60

Paketat e udhëtimit dhe të dhënat bazë të kontratës me udhëtarin

1.Paketë udhëtimi konsiderohet kombinimi i të paktën dy llojeve të ndryshme të shërbimeve të udhëtimit për qëllime të të njëjtit udhëtim ose pushim, kur:

a) këto shërbime kombinohen nga një tregtar i vetëm, përfshirë me kërkesë ose në përputhje me përzgjedhjen e udhëtarit, përpara lidhjes së një kontrate të vetme për të gjitha shërbimet; ose

b) pavarësisht nëse lidhen kontrata të veçanta me ofrues individualë të shërbimeve të udhëtimit, këto shërbime:

i. blihen nga një pikë e vetme shitjeje dhe janë përzgjedhur përpara se udhëtari të pranojë të paguajë;

ii. ofrohen, shiten ose faturohen me një çmim gjithëpërfshirës ose total, pavarësisht çdo faturimi të veçantë;

iii. reklamohen ose shiten me termin "paketë" ose me një term të ngjashëm;

iv. kombinohen pas lidhjes së një kontrate, me anë të së cilës një tregtar i jep udhëtarit të drejtën të zgjedhë ndërmjet një përzgjedhjeje të llojeve të ndryshme të shërbimeve të udhëtimit; ose

v. blihen nga tregtarë të ndryshëm nëpërmjet proceseve të lidhura të rezervimit online, kur të dhënat personale të udhëtarit, nëpërmjet të cilave udhëtari mund të identifikohet si palë kontraktuese, transmetohen nga tregtari me të cilin lidhet kontrata e parë te një tregtar tjetër ose tregtarë të tjerë dhe një kontratë me atë tregtar tjetër ose ata tregtarë të tjerë lidhet jo më vonë se 24 orë pas konfirmimit të rezervimit të shërbimit të parë të udhëtimit.

2.Kombinimi i jo më shumë se një lloji të shërbimeve të udhëtimit të përcaktuara në shkronjat "a", "b" ose "c" të përkufizimit "Shërbim udhëtimi", të nenit 4 të këtij ligji, me një ose më shumë shërbime turistike të përcaktuara në shkronjën "ç" të të njëjtit përkufizim, nuk konsiderohet paketë udhëtimi kur këto të fundit:

a) nuk përbëjnë të paktën 25 për qind të vlerës së kombinimit dhe as nuk reklamohen apo paraqiten në ndonjë mënyrë tjetër si element thelbësor i tij; ose

b) përzgjidhen dhe blihen vetëm pas fillimit të ofrimit të një prej shërbimeve të udhëtimit të përcaktuara në shkronjat "a", "b" ose "c" të përkufizimit "Shërbim udhëtimi", të nenit 4 të këtij ligji.

3.Kontrata e paketës së udhëtimit lidhet në përputhje me këtë ligj, legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

4.Informacioni parakontraktor, forma dhe përmbajtja e kontratës, ndryshimi, transferimi dhe zgjidhja e saj, përgjegjësia për përmbushjen e shërbimeve të udhëtimit, ndihma ndaj udhëtarit, rimbursimi i pagesave, përdorimi i kuponëve, mbrojtja në rast paaftësie paguese dhe trajtimi i

ankesave rregullohen sipas këtij ligji, legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

5. Rregullat e hollësishme për të drejtat dhe detyrimet e palëve në kontratat e paketave të udhëtimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas pikës 3 të nenit 150 të ligjit nr. 116/2026, "Për mbrojtjen e konsumatorit".

KREU IX
UDHËRRËFYESI TURIST

KREU IX
UDHËRRËFYESI TURISTIK

Neni 61
Kategoritë e udhërrëfyesit turistik në Republikën e Shqipërisë

1.Udhërrëfyesi turistik në Republikën e Shqipërisë ndahet në kategoritë e mëposhtme:

a) udhërrëfyes turistik kombëtar, personi, i cili mund të udhëheqë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) udhërrëfyes turistik lokal, personi, i cili mund të udhëheqë vetëm në një zonë të kufizuar;

c) udhërrëfyes i specialitetit të veçantë, personi, i cili mund të udhëheqë veprimtari të turizmit të aventurës dhe të interesit të veçantë.

2. Kriteret profesionale dhe administrative për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik zbatohen në mënyrë të njëjtë dhe jodiskriminuese. Nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, ndaj shtetasve të shteteve anëtare të Bashkimit Europian dhe Zonës Ekonomike Europiane zbatohen vetëm kërkesat e domosdoshme, proporcionale dhe jodiskriminuese, në përputhje me legjislacionin për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve.

Neni 62
Kriteret për certifikimin e udhërrëfyesit turistik

1. Veprimtaria e udhërrëfyesit lejohet për t'u ushtruar, pas pajisjes së këtij të fundit me certifikatë.

2. Kërkuesi ndjek programin e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik, sipas kategorive përkatëse, para paraqitjes së kërkesës për t'u pajisur me certifikatën e udhërrëfyesit turistik tek ofruesit e miratuar nga ministria përgjegjëse e turizmit. Programi i kualifikimit dhe kushtet që duhet të plotësojnë ofruesit e këtyre programeve miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

3. Kriteret dhe procedurat për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, rastet dhe procedurat për pezullimin dhe heqjen e certifikatës, detyrat, përgjegjësitë dhe kodi i etikës së udhërrëfyesve turistikë, si dhe kërkesat për edukimin profesional të vazhdueshëm të udhërrëfyesve turistikë përcaktohen me rregullore të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Ministria përgjegjëse për turizmin lëshon certifikatën e udhërrëfyesit turistik për kategorinë dhe gjuhën përkatëse të udhërrëfyesit.

5. Certifikata e udhërrëfyesit turistik regjistrohet në Regjistrin Qendror të Turizmit, që administrohet nga struktura përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.
6. Certifikata e udhërrëfyesit turistik duhet të përmbajë:
a) emrin dhe mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes;
b) kategorinë e udhërrëfyesit turistik;
c) territorin ku do të ushtrojë veprimtarinë si udhërrëfyes turistik, sipas kategorisë përkatëse;
ç) gjuhën në të cilën ai do të ushtrojë veprimtarinë si udhërrëfyes turistik;
d) datën e lëshimit të certifikatës.
7. Certifikata e udhërrëfyesit turistik është pa afat.

Neni 63
Dokumenti identifikues i një udhërrëfyesi turistik

1. Një udhërrëfyes turistik i certifikuar pajiset me dokument identifikues zyrtar, që tregon se ai është i certifikuar për të vepruar si udhërrëfyes turistik. Dokumenti identifikues, i cili përmban emrin e mbiemrin dhe të dhënat e përcaktuara në shkronjat "b" deri në "d" të pikës 6 të nenit 62 të këtij ligji, përgatitet nga struktura përkatëse në ministri dhe i dorëzohet subjektit bashkë me certifikatën.

2. Udhërrëfyesi turistik mban dokumentin identifikues zyrtar në një vend të dukshëm gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

3. Nëse dokumenti identifikues i udhërrëfyesit turistik dëmtohet, shkatërrohet ose humbet, ky i fundit duhet të paraqesë kërkesë pranë strukturës përgjegjëse në ministri për t'u pajisur me një dokument të ri identifikues.

4. Nëse një dokument identifikues i dëmtuar zëvendësohet me një të ri, udhërrëfyesi turistik, me marrjen e dokumentit të ri, duhet të kthejë të vjetrin.

5. Në rastet e pezullimit dhe heqjes së certifikatës së udhërrëfyesit turistik, ky i fundit duhet ta kthejë dokumentin identifikues pranë strukturës përgjegjëse në ministri, brenda 5 ditëve.

Neni 64
Kualifikimi dhe edukimi profesional në vazhdim i udhërrëfyesve turistikë

1. Ministria përgjegjëse për turizmin:

a) harton programet e kualifikimit të udhërrëfyesve turistikë;

b) nxit, mbështet dhe bashkëpunon me institucionet e akredituara prej saj dhe institucione të tjera për organizimin e kurseve të edukimit profesional në vazhdim dhe të seminareve informuese për udhërrëfyesit turistikë, me qëllim ruajtjen e standardeve të shërbimit të udhërrëfimit turistik, për të përditësuar dhe pasuruar njohuritë e udhërrëfyesit turistik me të dhëna të reja.

2. Ministri përgjegjës për turizmin miraton programet e kualifikimit, rregulloren përkatëse dhe procedurën për akreditimin e ofruesve të tyre.

Neni 65
Udhërrëfyesi turistik i huaj

1. Udhërrëfyesi turistik i huaj, i cili nuk është i certifikuar në Republikën e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, mund të shoqërojë grupe vizitorësh apo turistësh të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e shoqëruesit të udhëtimit. Gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie, grupi duhet të shoqërohet nga një udhërrëfyes turistik i certifikuar sipas këtij ligji, në bazë të një kontrate shërbimi, i cili duhet të jetë i pranishëm gjatë vizitës në territorin e Republikës së Shqipërisë

2. Nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, parashikimet e pikës 1 të këtij neni nuk zbatohen për udhërrëfyesit turistikë që ofrojnë shërbime përkohësisht dhe rastësisht në kushtet e nenit 66 të këtij ligji.

3. Shtetasi i huaj që ushtron profesionin e udhërrëfyesit turistik në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të përmbushë kriteret sipas pikës 3 të nenit 62 të këtij ligji.

Neni 66

Ofrimi i shërbimeve nga udhërrëfyesit turistikë të Bashkimit Evropian dhe Zonës Ekonomike Evropiane

1. Udhërrëfyesi turistik, i cili është i vendosur ligjërisht dhe ushtron ligjërisht profesionin në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose të Zonës Ekonomike Evropiane, mund të ofrojë përkohësisht dhe rastësisht shërbime të udhërrëfyesit turistik në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për njohjen e kualifikimeve profesionale, pa iu nënshtruar kërkesës për pajisje me certifikatën shqiptare të udhërrëfyesit turistik.

2. Përjashtimisht nga pika 1 e këtij neni, për ofrimin e shërbimeve të udhërrëfimit turistik në objekte, zona ose lokalitete të posaçme të trashëgimisë historike, arkeologjike dhe/ose kulturore, mund t'i nënshtrohet kërkesave të veçanta profesionale, proporcionale dhe jodiskriminuese, të nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, sipas legjislacionit në fuqi për njohjen e kualifikimeve profesionale.

3. Lista e objekteve, zonave dhe lokaliteteve të posaçme të parashikuara në pikën 2 të këtij neni miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin, pas marrjes së mendimit të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Neni 67

Udhërrëfyesi turistik i nderit

1. Shkencëtarëve të shquar dhe ekspertëve nga fusha të caktuara si dhe profesionistëve në fushën e udhërrëfyesve, të dalë në pension, mund t'u njihet cilësia e udhërrëfyesit turistik të nderit.

2. Udhërrëfyesi turistik i nderit mund të ushtrojë veprimtarinë e udhërrëfimit turistik për qëllime edukative, shkencore, kulturore ose promovuese, sipas kushteve të përcaktuara në aktin e njohjes së kësaj cilësie.

3. Kushtet, kriteret dhe procedura për njohjen e cilësisë së udhërrëfyesit turistik të nderit miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin. Kriteret dhe procedura bëhen publike paraprakisht dhe janë objektive, të qarta dhe transparente.

KREU X
TRANSPORTI TURISTIK DHE SIPËRMARRJET E TJERA TURISTIKE

Neni 68
Transporti turistik

1. Veprimtaria e transportit turistik ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon fushën e transportit.

2. Transportuesi turistik ushtron vetëm veprimtarinë për të cilën është licencuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ofrimi i shërbimit të transportit turistik, në kuadër të veprimtarisë së operatorit turistik, rregullohet me kontratë shërbimi ndërmjet operatorit turistik dhe transportuesit turistik.

3. Kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së transportit turistik, si dhe rregullat për ofrimin e shërbimit turistik të vizitave panoramike me autobus (Open Bus / Hop-on Hop-off), përfshirë kushtet e operimit, itineraret, ndalesat, informimin e turistëve dhe bashkërendimin me autoritetet përgjegjëse për transportin dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për turizmin dhe ministrit përgjegjës për transportin.

Neni 69
Stacionet e plazhit

1. Veprimtaria e stacionit të plazhit ushtrohet në bazë të një kontrate për përdorimin e hapësirës së plazhit, të lidhur midis subjektit dhe autoritetit publik kompetent dhe organizohet në hapësirë në përputhje me hartën e përgjithshme për plazhet e lejuara dhe planvendosjet përkatëse, të miratuara nga organet përgjegjëse.

2. Subjekti që ushtron veprimtarinë e stacionit të plazhit informon pushuesit nëpërmjet afishimit të kritereve dhe kushteve të sigurisë së shëndetit dhe jetës për aspektet teknike të veprimtarisë së stacionit të plazhit.

3. Subjekti që ushtron veprimtarinë e stacionit të plazhit ka detyrimin të mirëmbajë dhe të parandalojë ndotjen e hapësirës së plazhit që ka marrë në përdorim, sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Subjekti që ushtron veprimtarinë stacion plazhi duhet të garantojë aksesin e lirë, të pandërprerë dhe lëvizjen e lirë të publikut drejt bregut të detit përgjatë vijës bregdetare dhe ndërmjet hapësirave publike të plazhit. Ndalohet vendosja e gardheve, mureve, barrierave apo e çdo pengese tjetër fizike, të përhershme ose të përkohshme, që kufizon ose pengon këtë akses dhe lëvizje. Çdo veprim i kryer në kundërshtim me këtë pikë është i pavlefshëm dhe përbën shkelje sipas këtij ligji.

5. Rregullorja për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin dhe përmban:

a) kushtet teknike minimale sipas tipologjisë së plazhit;

b) kërkesat për sigurinë shëndetësore dhe higjienën;

c) kërkesat për sigurinë;

ç) kërkesat dhe kushtet për vrojtuesin e plazhit;

d) kërkesat për aksesin dhe përdorimin e plazhit nga personat me aftësi të kufizuara.

Neni 70

Detyrime të tjera për sipërmarrjet turistike

1. Çdo sipërmarrës turistik ekspozon në vend të dukshëm për publikun emrin e biznesit, si dhe procedurën e ankimit të paktën në gjuhën shqipe dhe angleze.

2. Çdo strukturë akomoduese dhe stacion plazhi ekspozon dukshëm listat e çmimeve për produktin dhe shërbimin që ofron të paktën në gjuhën shqipe dhe angleze.

3. Çdo sipërmarrës turistik gjatë ushtrimit të veprimtarisë garanton sigurimin e standardeve të shërbimit që ofron, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

4. Çdo sipërmarrës turistik gjatë ushtrimit të veprimtarisë duhet të ketë një kontratë të vlefshme sigurimi për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve, përfshirë aftësinë paguese dhe falimentin. Kontrata e sigurimit lidhet me një shoqëri sigurimi në përputhje me dispozitat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për sigurimet dhe risigurimet, si dhe mbulon dëmet e parashikuara më sipër, si dhe ato të parashikuara në kuadrin ligjor për mbrojtjen e konsumatorit.

5. Kur, sipas këtij ligji, për ushtrimin e veprimtarisë së një sipërmarrjeje turistike kërkohet kontratë sigurimi ose garanci financiare, njihet kontrata e sigurimit ose garancia financiare e lëshuar nga një shoqëri sigurimi ose institucion financiar i krijuar dhe i autorizuar në një nga Palët e CEFTA-s, me kusht që mbulimi i ofruar të jetë i barasvlershëm me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

6. Nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, kur organizatori i paketave të udhëtimit është i vendosur në një shtet tjetër, anëtar të Bashkimit Evropian ose të Zonës Ekonomike Evropiane, konsiderohet se i përmbush kërkesat e këtij ligji për mbrojtjen nga paaftësia paguese, nëse e ka siguruar këtë mbrojtje në përputhje me legjislacionin e shtetit ku është i vendosur, që zbaton legjislacionin e Bashkimit Evropian për paketat e udhëtimit.

7. Mbrojtja nga paaftësia paguese e organizatorit të paketave të udhëtimit duhet të jetë efektive dhe në çdo kohë e mjaftueshme për të mbuluar rimbursimin e të gjitha pagesave të kryera nga ose në emër të udhëtarëve për shërbimet e udhëtimit që nuk realizohen plotësisht ose pjesërisht për shkak të paaftësisë paguese të organizatorit dhe, kur transporti i udhëtarëve përfshihet në paketë, shpenzimet e riatdhesimit të tyre. Mjaftueshmëria e mbrojtjes vlerësohet duke marrë në konsideratë periudhën ndërmjet marrjes së pagesave dhe përfundimit të paketave të udhëtimit, kostot e parashikueshme të riatdhesimit, periudhat me nivelin më të lartë të pagesave të udhëtarëve dhe ndryshimet në vëllimin e shitjeve. Për kontratat e sigurimit ose garancitë financiare të parashikuara në pikën 5 të këtij neni, verifikohet barasvlershmëria e mbulimit me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Kur mbulimi i ofruar nuk i përmbush plotësisht këto kërkesa, kërkohet vetëm mbulim plotësues në masën e nevojshme për përmbushjen e tyre. Procedura e verifikimit të barasvlershmërisë dhe e mbulimit plotësues zbatohet pa cenuar parimin e njohjes së ndërsjellë të mbrojtjes nga paaftësia paguese të parashikuar në pikën 6 të këtij neni.

8. Rregullat e hollësishme për formën, masën, mënyrën e llogaritjes dhe kushtet e mbrojtjes nga paaftësia paguese, si dhe kriteret, dokumentacioni, autoriteti përgjegjës dhe procedura për verifikimin e barasvlershmërisë dhe të mbulimit plotësues, propozohen nga ministri përgjegjës

për financat dhe ministri përgjegjës për turizmin dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave

9. Çdo sipërmarrës turistik ka detyrimin të vendosë në një vend të dukshëm për publikun kontratën e sigurimit të përgjegjësisë ndaj palëve të treta.

10. Çdo sipërmarrës turistik, i cili ofron shërbimet e veta online, ka detyrimin që në faqen e tij të publikojë informacionin sipas pikave 1, 2 dhe 9 të këtij neni.

11. Sipërmarrësi turistik ka detyrimin të deklarojë kapacitetin e shfrytëzimit të strukturës akomoduese, i cili për qëllime tatimore nuk mund të jetë më i vogël se niveli minimal i shfrytëzimit. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin dhe të ministrit përgjegjës për financat, përcakton periudhën e shfrytëzimit dhe nivelin minimal të kapacitetit të shfrytëzimit për strukturat akomoduese.

KREU XI
STATISTIKAT

Neni 71
Parimet bazë

1. Mbledhja e të dhënave statistikore bëhet në përputhje me parimet e paanshmërisë, të besueshmërisë, transparencës, ruajtjes së konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave, bazuar në legjislacionin në fuqi për statistikat zyrtare dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas metodologjisë së përcaktuar nga autoritetet përgjegjëse për statistikat zyrtare, me qëllim studimin e ecurisë së zhvillimit të turizmit në nivel kombëtar.

2. Struktura që merret me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga strukturat akomoduese, operatorët apo agjencitë e udhëtimit është përgjegjëse për ruajtjen e konfidencialitetit të tyre. Përpunimi, përdorimi dhe komunikimi i të dhënave kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për statistikat zyrtare dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 72
Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave statistikore

1. Ministria përgjegjëse për turizmin ngre në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës për koordinimin e bazave të të dhënave shtetërore, sistemin e të dhënave në turizëm dhe është përgjegjëse për administrimin e të dhënave të këtij sistemi. Të dhënat parësore dhe dytësore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

2. Struktura përgjegjëse për të dhënat statistikore pranë kësaj ministrie mbledh e përpunon të dhëna me bazë mujore dhe prodhon statistika për turizmin duke u mbështetur në:

a) të dhënat administrative të institucioneve publike qendrore dhe vendore, përgjegjëse për furnizimin me të dhëna administrative;

b) të dhënat nga strukturat akomoduese dhe njësit akomoduese për qëndrime afatshkurtra për numrin e vizitorëve, numrin e netëve të qëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën;

c) të dhënat nga operatorët turistikë dhe agjencitë e udhëtimit për numrin total të vizitorëve për turizmin pritës dhe turizmin në dalje, shtetësinë dhe destinacionin.

ç) çdo e dhënë tjetër parësore dhe dytësore e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Subjektet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni kanë detyrimin të raportojnë të dhëna të vërteta dhe të sakta sipas parimeve të statistikave zyrtare.

4. Të dhënat sigurohen pa pagesë, në formën, afatet dhe mënyrën e përcaktuar sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

5. Të dhënat e vëna në dispozicion të ministrisë përgjegjëse për turizmin përdoren vetëm për qëllime statistikore.

6. Të dhënat e mbledhura sipas pikës 5 të këtij neni i dërgohen Institutit të Statistikave.

KREU XII
EDUKIMI NË FUSHËN E TURIZMIT

Neni 73
Objektivat e edukimit në fushën e turizmit

Ministria përgjegjëse për turizmin nxit edukimin në fushën e turizmit me objektivat e mëposhtëm:

a) nxitjen e njohjes dhe promovimit të historisë, kulturës, trashëgimisë kulturore, bukurive natyrore, traditave dhe artizanatit si vlera në funksion të zhvillimit të turizmit;

b) rritjen e ndërgjegjësimit social për turizmin, krijimi i një mjedisi të hapur e miqësor për turistët dhe zhvillimi i traditës së mikpritjes.

Neni 74
Edukimi, trajnimi dhe puna kërkimore

1. Ministria përgjegjëse për turizmin nxit dhe fuqizon kapacitetet njerëzore të sektorit të turizmit, përmes:

a) përfshirjes në fushata për nxitjen e ndërgjegjësimit në popullatën e gjerë për kontributin e sektorit të turizmit në ekonominë vendase, përfitimet e tjera pozitive dhe mundësitë që sektori ofron për punësimin dhe zhvillimin profesional;

b) përfshirjes së çështjeve të turizmit, si sektor i rëndësishëm ekonomik, në të gjitha ciklet e sistemit arsimor;

c) nxitjes së kurseve të trajnimit profesional në shkolla dhe qendra të formimit profesional për sektorin e turizmit;

ç) dhënies së çmimeve kombëtare të suksesit apo të ekselencës, për shërbimet në fushën e turizmit, sipërmarrjeve turistike apo individëve të veçantë.

2. Ministria përgjegjëse për turizmin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, nxit edukimin profesional në fushën e turizmit, me qëllim ruajtjen e standardeve dhe përmirësimin e shërbimit të ofruar nga sektori i turizmit.

KREU XIII
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 75

Përmbajtja e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e turizmit

Bashkëpunimi ndërkombëtar nxitet në fushat e mëposhtme:

a) studimin, mbrojtjen, promovimin dhe zhvillimin e burimeve turistike;

b) zhvillimin dhe diversifikimin e produkteve turistike;

c) marketingun dhe promovimin e turizmit;

ç) pjesëmarrjen në programe dhe iniciativa të përbashkëta të organizatave rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e turizmit;

d) zhvillimin e burimeve njerëzore dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e turizmit;

dh) kërkimin shkencor, inovacionin, digjitalizimin dhe përdorimin e teknologjive të avancuara në fushën e turizmit;

e) shkëmbimin e ekspertëve, informacionit, praktikave më të mira dhe përvojave në fushën e turizmit;

ë) mbrojtjen e mjedisit dhe të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në destinacionet turistike;

f) hartimin dhe zbatimin e programeve, planeve dhe strategjive për zhvillimin e turizmit.

Neni 76

Marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare të turizmit

1. Ministria përgjegjëse për turizmin përfaqëson Shqipërinë në organizatat rajonale dhe ndërkom-bëtare të turizmit.

2. Shoqatat, organizatat dhe sipërmarrjet turistike shqiptare kanë të drejtë të aderojnë dhe të marrin pjesë në organizata, rrjete dhe struktura ndërkombëtare në fushën e turizmit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU XIV

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 77

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) ushtrimi i veprimtarisë si strukturë akomoduese pa certifikatë kategorizimi, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 46 të këtij ligji, dënohet me gjobë bazuar në numrin e dhomave si më poshtë:

i. nga 1 deri në 5 dhoma me 20 000–50 000 lekë;

ii. nga 6 deri në 15 dhoma me 100 000 lekë;

iii. nga 16 deri në 40 dhoma me 200 000 lekë;

iv. nga 41 deri në 80 dhoma me 300 000 lekë;

v. mbi 80 dhoma me 400 000 lekë.

b) përdorimi i paautorizuar apo i gabuar i shenjave dalluese në strukturën akomoduese, pa u kryer procesi i klasifikimit sipas nenit 47 të këtij ligji, dënohet me gjobë 200 000 lekë;

c) ushtrimi i veprimtarisë si agroturizëm pa certifikatën përkatëse, sipas pikës 2 të nenit 49 të këtij ligji, dënohet me gjobë, bazuar në numrin e dhomave, si më poshtë:

i. deri në 5 dhoma 50 000 lekë;

ii. mbi 5 dhoma 100 000 lekë.

ç) mosrespektimi i kritereve për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit, sipas nenit 49 të këtij ligji, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

d) ushtrimi i veprimtarisë pa licencën përkatëse, sipas pikës 1 të nenit 52 të këtij ligji, dënohet me gjobë 200 000 lekë;

dh) ushtrimi i veprimtarisë pa licencën përkatëse, sipas pikës 1 të nenit 56 të këtij ligji, dënohet me gjobë 300 000 lekë;

e) ushtrimi i veprimtarisë, pa plotësuar kërkesat e përcaktuara, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të nenit 59 të këtij ligji, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

ë) ushtrimi i veprimtarisë pa kontratë ose pa plotësuar të dhënat bazë, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 60 të këtij ligji, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

f) ushtrimi i veprimtarisë pa certifikatë, sipas pikës 1 të nenit 62, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

g) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesën e përcaktuar në pikën 2 të nenit 63 të këtij ligji dënohet me gjobë 20 000 lekë;

gj) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 65 të këtij ligji dënohet me gjobë 100 000 lekë;

h) mosrespektimi i detyrimit për mbajtjen në mjetin e transportit të kontratës së lidhur mes transportuesit turistik dhe operatorit turistik apo agjencisë së udhëtimit, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 68 të këtij ligji, dënohet me gjobë 50 000 lekë;

i) mosrespektimi i kushteve dhe kritereve, sipas pikës 3 të nenit 68 të këtij ligji, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

j) ushtrimi i veprimtarisë pa kontratën përkatëse, sipas pikës 1 të nenit 69 të këtij ligji, dënohet me gjobë 300 000 lekë;

k) ushtrimi i veprimtarisë si stacion plazhi jashtë sipërfaqes së përcaktuar në kontratë sipas pikës 1 të nenit 69 të këtij ligji, dënohet me gjobë 150 000 lekë;

l) mosafishimi në mënyrë të dukshme i kërkesave të sigurisë në stacionin e plazhit, sipas pikës 2 të nenit 69 të këtij ligji, dënohet me gjobë 50 000 lekë;

ll) mosmirëmbajtja dhe ndotja e hapësirës së stacionit të plazhit, sipas pikës 3 të nenit 69 të këtij ligji, dënohet me gjobë 200 000 lekë;

m) moszbatimi i kushteve minimale teknike sipas tipologjisë së plazhit, sipas shkronjës "a" të pikës 5 të nenit 69 të këtij ligji, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

n) moszbatimi i kërkesave për kushtet e higjienës, sipas shkronjës "b" të pikës 5 të nenit 69 të këtij ligji dënohet me gjobë 200 000 lekë;

nj) moszbatimi i kërkesave për sigurinë në stacionin e plazhit, sipas shkronjës "c" të pikës 5 të nenit 69 të këtij ligji dënohet me gjobë 200 000 lekë;

o) mosplotësimi i kërkesave dhe kushteve për vrojtuesin e plazhit, sipas shkronjës "ç" të pikës 5 të nenit 69 të këtij ligji, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

p) mungesa e vrojtuesit të plazhit në stacionin e plazhit dënohet me gjobë 200 000 lekë; në rastet kur subjekti është përsëritës, dënohet me gjobë 400 000 lekë;

q) moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 70 të këtij ligji dënohet me gjobë 50 000 lekë;

r) mungesa e kontratës së sigurimit për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, sipas pikës 4 të nenit 70 të këtij ligji, nga sipërmarrësit turistikë dënohet me gjobë 200 000 lekë;

rr) mosdeklarimi i të dhënave statistikore nga strukturat akomoduese, operatorët turistikë dhe agjencitë e udhëtimit, sipas shkronjave "b" dhe "c" të pikës 2 të nenit 72 të këtij ligji, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

s) deklarimi i pasaktë i të dhënave statistikore, sipas nenit 72 të këtij ligji, dënohet me gjobë 100 000 lekë.

sh) moszbatimi i kritereve sipas përcaktimeve të nenit 33 dënohet me gjobë 2 000 000 lekë;

t) mosrespektimi i kritereve të përcaktuara në nenin 69, pika 4, dënohet me gjobë 200 000 lekë.

2. Në rast përsëritjeje të së njëjtës kundërvajtje administrative brenda një periudhe 12-mujore, masa e gjobës mund të vendoset deri në dyfishin e kufirit maksimal të parashikuar.

3. Gjoba, në zbatim të këtij neni, përbën titull ekzekutiv me përfundimin e shqyrtimit të ankimit administrativ dhe vendoset nga struktura përgjegjëse inspektuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin.

4. Gjoba e parashikuar në pikën 2 të këtij neni paguhet brenda 10 ditëve nga data kur vendimi i dënimit me gjobë është bërë titull ekzekutiv, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 78

Ankimi

1. Ankimi administrativ ndaj gjobave dhe masave të tjera administrative të vendosura nga struktura përgjegjëse për inspektimin bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

2. Ankimi administrativ ndaj akteve që lidhen me licencat bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

3. Pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, palët kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës kompetente administrative, brenda afateve dhe sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative

Neni 79

Të ardhurat nga vendosja e gjobave

1. Të ardhurat nga gjobat e vendosura sipas këtij ligji derdhen në masën 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

KREU XV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 80
Dispozita kalimtare

1. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, vazhdojnë të zbatohen deri në hyrjen në fuqi të akteve të reja nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji, për aq sa nuk bien në kundërshtim me të.

2. Procedurat administrative të filluara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji vijojnë dhe përfundojnë sipas dispozitave në fuqi në kohën e fillimit të tyre, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.

3. Për lejet e ndërtimit ose autorizimet e tjera të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, autoritetet kompetente që i kanë lëshuar ato, me kërkesë të subjektit, miratojnë shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve ose të aktivitetit, kur zbatohet pezullimi sezonal sipas këtij ligji, duke marrë në konsideratë kohëzgjatjen e periudhës së pezullimit.

4. Agjencia Kombëtare e Turizmit, e krijuar sipas ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, vijon veprimtarinë e saj si agjencia përgjegjëse për promovimin e turizmit dhe organizimin e ngjarjeve, duke ruajtur personalitetin juridik, si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj.

5. Marrëdhëniet e punës, pasuritë, të drejtat, detyrimet, kontratat dhe procedurat administrative në proces të Agjencisë Kombëtare të Turizmit vijojnë dhe administrohen nga agjencia përgjegjëse për promovimin e turizmit dhe organizimin e ngjarjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Deri në hyrjen në fuqi të akteve të reja nënligjore për organizimin dhe funksionimin e agjencisë përgjegjëse për promovimin e turizmit dhe organizimin e ngjarjeve, aktet nënligjore ekzistuese që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit vazhdojnë të zbatohen, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

7. Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e agjencisë përgjegjëse për promovimin e turizmit dhe organizimin e ngjarjeve.

8. Deri në miratimin e strukturës dhe organikës së re, vazhdon të zbatohet struktura dhe organika ekzistuese e Agjencisë Kombëtare të Turizmit, për aq sa nuk bie në kundërshtim me këtë ligj.

9. Agjencia Kombëtare e Bregdetit, e organizuar sipas ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, vijon veprimtarinë e saj si agjencia përgjegjëse për menaxhimin e integruar të zonës bregujore, duke ruajtur personalitetin juridik, si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj.

10. Marrëdhëniet e punës, pasuritë, të drejtat, detyrimet, kontratat dhe procedurat administrative në proces të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit vijojnë dhe administrohen nga agjencia përgjegjëse për menaxhimin e integruar të zonës bregujore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11. Deri në hyrjen në fuqi të akteve të reja nënligjore për organizimin dhe funksionimin e agjencisë përgjegjëse për menaxhimin e integruar të zonës bregujore, aktet nënligjore

ekzistuese që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit vazhdojnë të zbatohen, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

12. Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore për organizimin, funksionimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e agjencisë përgjegjëse për menaxhimin e integruar të zonës bregujore.

13. Certifikatat, licencat, regjistrimet dhe autorizimet e lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji mbeten të vlefshme deri në përfundimin e afatit të tyre ose deri në zëvendësimin e tyre sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 81

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 9 (nëntë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 3 të nenit 11; pikave 3 dhe 5 të nenit 12; pikës 2 të nenit 13; pikave 3 dhe 5 të nenit 14; të pikës 5 të nenit 16; pikës 2 të nenit 25; pikës 3 të nenit 28; pikës 4 të nenit 33; pikës 1 të nenit 40; pikës 4 të nenit 42; pikës 3 të nenit 43; pikës 3 të nenit 46; pikës 1 dhe 5 të nenit 47; pikës 3 të nenit 49; pikës 3 të nenit 52; pikës 3 të nenit 56; pikës 5 të nenit 60; pikës 3 të nenit 62; pikës 5 të nenit 69; pikës 8 të nenit 70 dhe pikës 1 të nenit 72 të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për turizmin që, brenda 9 (nëntë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2 të nenit 9; pikës 4 të nenit 10; të pikës 5 të nenit 17; nenit 18; pikës 4 të nenit 20; pikës 5 të nenit 23; pikave 3 dhe 5 të nenit 29; të nenit 34; pikës 2 të nenit 36; pikës 4 të nenit 37; pikës 7 të nenit 44; pikës 3 të nenit 48; pikës 2 të nenit 62; pikës 2 të nenit 64; pikës 3 të nenit 66 dhe pikës 3 të nenit 67 të këtij ligji.
3. Ngarkohen ministri përgjegjës për turizmin dhe ministri përgjegjës për ekonominë që, brenda 9 (nëntë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të pikës 4 të nenit 53 dhe pikës 4 të nenit 57 të këtij ligji.
4. Ngarkohen ministri përgjegjës për turizmin dhe ministri përgjegjës për transportin që, brenda 9 (nëntë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të pikës 3 të nenit 68 të këtij ligji.
5. Ngarkohet Kryeministri që, brenda 9 (nëntë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë urdhrat për miratimin e strukturës dhe organikës, në zbatim të pikës 4 të nenit 12 dhe pikës 4 të nenit 14 të këtij ligji.

Neni 82

Dispozitave të kushtëzuara nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian

Dispozitat e neneve të këtij ligji, vetëm për pjesët që parashikojnë zbatimin nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, fillojnë të zbatohen nga kjo datë.

Neni 83

Shfuqizime

Ligji nr. 93/2015 "Për turizmin", të ndryshuar, dhe çdo dispozitë që vjen në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 84

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Niko PELESHI